

**PERCEPTIMI PUBLIK NË LIDHJE ME
PJESËMARRJEN E GRAVE NË ZGJEDHJE NË
SHQIPËRI**

- - VROJTIM -

2008

**Përgatiti: -Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (ACER) dhe
Forumi Shqiptar Social Ekonomik (ASET)
Me mbështetjen e Fondit të Zhvillimit
të Kombeve të Bashkuara për Gratë - UNIFEM**

Falënderime

Ekipi i **Qendrës Shqiptare për Kërkime Ekonomike (ACER) dhe Forumi Shqiptar Social Ekonomik (ASET)** dëshiron të shprehë mirënjohjen për bashkëpunimin dhe asistencën e dhënë nga zyrtarët dhe punonjësit e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe agjencitë shtetërore me të cilat është konsultuar në kuadër të këtij projekti. Dëshirojmë të falënderojmë, veçanërisht, ekipin e zyrës UNIFEM në Shqipëri për mbështetjen e vazhdueshme të tyre.

TRYEZA E LËNDËS

I. PËRMBLEDHJE E KONSTATIMEVE	5
II. HYRJE	9
III. METODIKA E VROJTIMIT DHE KUFIJTË E GABIMIT	13
IV. SI DHE PËRSE VOTOJNË FEMRAT DHE MESHKUJT?	15
V. FEMRAT DHE MESHKUJT SI ZYRTARË TË ZGJEDHUR DHE TË EMËRUAR	26
ANEKSI I: PROFILI I Pjesëmarrësve në vrojtimit	51

Lista e Grafikëve

Grafiku 1: Votimi në zgjedhjet e vitit 2007.....	15
Grafiku 2: Pjesëmarrja e votuesve në zgjedhjet vendore të datës 18 shkurt 2007.....	16
Grafiku 3: Arsyet kryesore për mospjesëmarrjen në votim	17
Grafiku 4: Arsyja për mos-votim	19
Grafiku 5: A keni qenë dëshmitarë të votimit në familje/në grup	19
Grafiku 6: Vlerësimi i pengesave ndaj pjesëmarrjes së femrave si votuese	20
Grafiku 7: Votimi me asistencën e një të treti.....	20
Grafiku 8: Shtrirja e asistencës gjatë votimit	21
Grafiku 9: Grupet që asistojnë votuesit.....	21
Grafiku 10: Hedhja e votës suaj.....	22
Grafiku 11: Motivimi i qytetarëve për përzgjedhjen që kanë bërë në zgjedhjet e fundit.....	23
Grafiku 12: Çështjet kryesore për qytetarët.....	23
Grafiku 13: Çështjet kryesore nga këndvështrimi i votueseve femra	24
Grafiku 14: Çështjet kryesore nga këndvështrimi i votuesve meshkuj	24
Grafiku 15: Pjesëmarrja në zgjedhjet e ardhshme, me shpërndarjen sipas gjinive	25
Grafiku 16: Pranimi/mospranimi i rritjes së pranisë së grave në jetën publike.....	26
Grafiku 17: Shkalla në të cilën postet e emëruara duhet të përfaqësohen nga femra	28
Grafiku 18: Rregullat për përqindjen e përfaqësimit të femrave në politikë	28
Grafiku 19: Pranimi/mospranimi i normave legjislative mbi përqindjen minimale të kandidateve femra në zgjedhje.....	29
Grafiku 20: Rregullat për pjesëmarrjen e femrave në administratën publike.....	29
Grafiku 21: Mbështetja e femrave për kandidatet femra	30
Grafiku 22: Mbështetja e meshkujve për kandidatet femra.....	30
Grafiku 23: Arsyet kryesore në mbështetje të votimit për kandidatet femra	32
Grafiku 24: Arsyet e grave në mbështetje të kandidateve femra.....	33
Grafiku 25: Arsyet e burrave në mbështetje të kandidateve femra.....	33
Grafiku 26: Arsyet kryesore për të mos i mbështetur kandidatet femra	34
Grafiku 27: Arsyet e grave për të mos i mbështetur kandidatet femra.....	35
Grafiku 28: Arsyet e burrave për të mos i mbështetur kandidatet femra	35
Grafiku 29: Pjesëmarrja e gruas në politikë	36
Grafiku 30: Mënyrat me të cilat mund të jenë aktive në politikë femrat.....	36

Grafiku 31: Ndikimi i disa faktorëve në jetën në bashkësi	37
Grafiku 32: Çfarë e pengon zgjedhjen e kandidatëve femra	38
Grafiku 33: Pengesat kryesore:	39
Grafiku 34: Çfarë i pengon femrat të jenë kandidatë në zgjedhje, sipas perceptimit të femrave	39
Grafiku 35: Çfarë i pengon femrat të jenë kandidatë në zgjedhje, sipas perceptimit të meshkujve	40
Grafiku 36: Ekzistenca e pengesave për zgjedhjen e grave	40
Grafiku 37: Pengesat për pjesëmarrjen e grave në zgjedhje	41
Grafiku 38: Pengesat	41
Grafiku 39: Shkalla në të cilën mjetet masive të komunikimit mbulojnë pjesëmarrjen e grave në zgjedhje	42
Grafiku 40: Vlerësimi i mundësisë për të përdorur mediat, për kandidatët meshkuj dhe femra	43
Grafiku 41: Parapëlqimi për kandidatët femra dhe meshkuj	44
Grafiku 42: Parapëlqimi i votuesve për kandidatët, sipas gjinive	45
Grafiku 43: Parapëlqimi i votueseve femra	46
Grafiku 44: Parapëlqimi i votuesve meshkuj	47
Grafiku 45: Parapëlqimet për postet ku mund të zgjidhen/emërohen femrat	47
Grafiku 46: Parapëlqimet e votueseve femra për postet ku mund të zgjidhen/emërohen femrat	48
Grafiku 47: Sipas mendimit tuaj, do të ishin dakord që një femër të mund të zgjidhet/emërohet në postin e mëposhtëm? (Meshkujt)	49
Grafiku 48: Vlerësimi për kandidatët meshkuj (1 – tërësisht kundër; 5 – tërësisht pro)	50

Lista e Tabelave

Tabela 1: Zbërthimi i intervistave sipas gjinive	13
Tabela 2: Votuesit të cilët nuk votuan në zgjedhjet parlamentare të datës 3 korrik 2005	16
Tabela 3: Pjesëmarrësit në vrojtim të cilët nuk votuan në zgjedhjet e mëparshme	17

I. PËRMBLEDHJE E KONSTATIMEVE²

Angazhimet kombëtare dhe ndërkombëtare për gratë dhe vajzat mund të përmbushen vetëm nëse ekzistojnë, jo thjesht në letër, por në realitet, sistem të llogaridhënies që u përgjigjen çështjeve gjinore. "Llogaridhënia nga këndvështrimi i të drejtave të grave dhe vajzave ekziston atëherë kur të gjitha femrat të kenë mundësi të marrin shpjegime nga personat në pushtet për veprimet që i prekin ato dhe kur mund të vënë në lëvizje masa ndreqëse—si për shembull votimi—kur personat përgjegjës nuk i respektojnë të drejtat e tyre."³

Gjatë kryerjes së vrojtimit "Perceptimi publik i pjesëmarrjes së femrave në zgjedhjet në Shqipëri", "ACER dhe ASET" është përpjekur të marrë perceptimet që kanë njerëzit në lidhje me kuotën dhe konceptin e mësipërm dhe në lidhje me zbatimin e tyre në Shqipëri. Vrojtimi është përqendruar në dy çështje kryesore: (1) vrojtimi i praktikave të votimit përmes një thjerre gjinore—për të kuptuar se si dhe përse votojnë burrat dhe gratë; dhe (2) perceptimet e njerëzve në lidhje me pjesëmarrjen e grave në zgjedhje si votuese dhe si candidate, si edhe në lidhje me vendosjen e tyre në poste vendimmarrëse.

KONSTATIMET—NJË INFORMACION I SHKURTËR

Përse dhe si votojnë femrat dhe meshkujt:

- Pjesëmarrja si votues: Kur janë pyetur femrat dhe meshkujt për frekuencën e tyre në votim, përgjigjet treguan se kishte një pjesëmarrje më të madhe të votuesve në zgjedhjet vendore sesa në zgjedhjet e përgjithshme: 79% votuan në zgjedhjet vendore, në krahasim me 71% në zgjedhjet e përgjithshme.⁴ Në nivel vendor, votuan më shumë meshkuj se femra.
- Arsyet për mospjesëmarrje në votim: Ndërkohë që, nga përgjigjet, del qartë se meshkujt janë më të predispozuar për të votuar, raporti i votuesve meshkuj-femra nuk ndryshon shumë. Megjithatë, aty ku dalin më në pah dallimet midis gjinive, janë arsyet e mospjesëmarrjes në votim. Për femrat, arsyeja kryesore e

² Metodika e vrojtimit: Pyetësi i vrojtimit përbëhet nga 45 pyetje dhe nuk trajton pyetje specifike që kanë lidhje me bashkësitë e etnive të ndryshme, etj. Intervistat janë zhvilluar më 10-24 nëntor 2007, me 1.200 shtetas shqiptar mbi 18-vjeç, në 13 rrethe, të cilët janë përzgjedhur në mënyrë të rastësishme. Janë futur në studim përgjigjet e 1.168 personave, pas pastrimit të bazës së të dhënave. Shumica e gjetjeve përfaqësojnë përqindjen kundrejt numrit gjithsej, në përputhje me alternativat e vlerësuara nga personat e intervistuar, ndërsa një pjesë e tyre jepen si vlerësim nga 1 deri në 5, ose si vlerësim nga 0 deri në 10.

³ UNIFEM, "Përparimi i grave në botë, 2008/2009", faqe 3,

www.unifem.org/progress/2008

⁴ Megjithatë, rezultatet e pjesëmarrjes së qytetarëve në zgjedhjet parlamentare, sikurse përshkruhet në grafikun 3 tregojnë një nivel pjesëmarrjeje më të lartë se pjesëmarrja e raportuar gjatë zgjedhjeve në fjalë. Kjo vjen si rezultat i faktit se shumica e qytetarëve, në kohën kur është zhvilluar vrojtimi, nuk kishin qenë në Shqipëri, shumica e tyre kanë qenë të punësuar përkohësisht jashtë vendit, në mënyrë të ligjshme ose jo, në vendet e Bashkimit Evropian dhe në vende të tjera të botës, për të mos përmendur, për më tepër, intensitetin e këtij procesi, kryesisht në Greqi (punësim i paligjshëm) dhe Greqi, Itali, Gjermani, etj., (kryesisht punësim i ligjshëm), gjatë periudhës në fjalë.

mosvotimit ishte se **nuk ishin të regjistruara në listën e votuesve** (24,90%); ndërsa këtë përgjigje e dhanë vetëm 17,40% e meshkujve pjesëmarrës në vrojtim.

- **Votimi si familje:** Nga ata që nuk kanë votuar, 23,10% e femrave dhe 10,40% e meshkujve nuk votuan sepse as familjet e tyre nuk votuan. Këto shifra tregojnë qartë se femrat kanë më pak gjasa se meshkujt të jenë të angazhuara politikisht, nëse familjet e tyre vendosin të mos angazhohen.
 - 23% e personave të anketuar e kanë parë vetë dukurinë e votimit familjar në kabinat e votimit. Rezultatet tregojnë se ka një përqindje më të lartë të femrave që asistohen gjatë votimit në kabinat e votimit, në një mënyrë e cila shkon përtej asistencës për votuesin të lejuar me ligj. Ka më shumë të ngjarë që përqindja e lartë e femrave që asistohen të lidhet me dukurinë e votimit familjar, por, mbase, edhe me faktin se femrat mund të frikësohen më me lehtësi nga jofamiljarë gjatë votimit.
 - **Pengesat që hasin femrat në votim:** Përkundër këtyre fakteve, pyetjes nëse kishte ndonjë pengesë për femrat për të votuar, 60% e personave iu përgjigjën "jo".
- * **Përzgjedhja e kandidatëve:** Meshkujt dhe femrat u japin përparësi, në përgjithësi, problemeve të ngjashme si energjia, uji, kujdesi shëndetësor dhe sigurimet shoqërore. Divergjenca ka në lidhje me çështjet e arsimit (femrat vendosin një theks më të madh në këtë çështje) dhe korrupsionit (meshkujt vendosin një theks më të madh në këtë çështje).

Femrat dhe meshkujt si zyrtarë të zgjedhur dhe të emëruar

- Shumica e pjesëmarrësve në vrojtim (73,4%), meshkuj dhe femra, mendojnë se ka nevojë për ta rritur praninë e grave në jetën publike.
- **Perceptimet në lidhje me femrat si udhëheqëse:** Përgjigjet tregojnë qartë se zyrtaret femra (të zgjedhura apo të emëruara) perceptohen si më pak të korruptuara dhe më shumë të predispozuar për të përmirësuar të drejtat e njeriut, përfitimin nga shërbimet elementare (shëndetësia, arsimi, kujdesi social) dhe për të rritur mundësitë e Shqipërisë për integrim në BE.
- **Femrat në poste të emëruara:** Shumica e atyre që u janë përgjigjur pyetjeve (84,4% e grave dhe 61,7% e burrave) e mbështesin idenë që gratë të emërohen në poste vendore dhe qendrore. Ajo që është interesante është niveli i lartë i pasigurisë si të meshkujt ashtu edhe të femrat (por, më shumë të meshkujt), në lidhje me vendosjen e femrave në poste të emëruara.
- **Kuotat (normat e pjesëmarrjes) dhe masat e posaçme:** Në përgjithësi, pjesëmarrësit në vrojtim ishin në mbështetje të idesë së kuotave dhe masave të posaçme (48%). Siç mund të kuptohet, ka më shumë femra (46,30%) se meshkuj (36%) që e mbështesin idenë e masave të posaçme, megjithatë ajo që është interesante dhe e rëndësishme të vëresh është niveli i lartë i rezistencës dhe/ose pasigurisë për konceptin nga ana e të dyja gjinive: 34,7% e femrave kundrejt 46,10% e meshkujve.

- *Votimi për kandidatet femra:* Shumica e meshkujve (38%) dhe e femrave (34%) lanë të kuptosh se gjinia e kandidatit nuk përbënte as pengesë e as shtysë për të votuar.
- *Pjesëmarrësit në vrojtimit dhanë këto si arsye, që gratë* a) i kuptojnë më mirë çështjet shoqërore dhe familjare; b) perceptohen si më pak të korruptuara; c) nëse është kandidatja më e mirë për detyrën; dhe d) ajo ka më shumë gjasa se do t'i mbajë premtimet.
- Ndërsa ata të cilët nuk do të votonin për femrat, dhanë këto arsye kryesore:
 - Për meshkujt: a) arena politike është tepër agresive për një grua; një grua nuk do të kishte kohë të mjaftueshme për t'u marrë me çështjet e qeverisë, po të kemi parasysh përgjegjësitë që ka në shtëpi; c) dhe gratë nuk kanë përvojën apo lidhjet politike të mjaftueshme për të pasur mundësi të realizojnë detyrat.
 - Për femrat që u përgjigjën në vrojtimit, arsyet ishin se: a) për shkak të detyrave në familje, një grua nuk do të kishte kohë; b) ajo nuk ka lidhje të mira politike, dhe nuk mund t'i detyrojë vendimmarrësit ta mbajnë vesh, duke qenë se nuk do të ishte agresive sa duhet.
- *Çfarë i pengon femrat që të zgjidhen: Shumica e pjesëmarrësve në vrojtimit (45,6%) thanë se perceptojnë se ka një sërë pengesash që e pengon zgjedhjen e femrave.* Vihet re sidomos se pengesa kryesore e renditur ishte mungesa e mbështetjes nga politikanët meshkuj (38,6%) dhe mungesa e mbështetjes nga partitë politike (21,6%). Ky konstatim bashkëlidhet me shumë studime globale mbi femrat dhe politikën, sipas të cilëve partitë përbëjnë mekanizmin kryesor që mund të mbështesë apo të pengojë rritjen e angazhimit të grave në jetën politike dhe publike.

Pyetjet kyçe:

- **Pyetjes** "*Sikur kësaj të diele të mbahen zgjedhjet vendore dhe në zgjedhje të kishte dy kandidatë, një mashkull dhe një femër, a do të kishte më shumë mundësi të votonit për kandidaten femër?*" Më shumë se **një e treta e pjesëmarrësve** në vrojtimit thanë se ishin të pavendosur në lidhje me faktin se si do të ndikonte në vendimin e tyre gjinia e kandidatit. Kështu, përgjigja e përgjithshme për këtë pyetje duket se është "i pavendosur". Nga përgjigjet për pyetjen se si i përzgjedhin njerëzit kandidatët për të cilët votojnë dhe se cilët faktorë ndikojnë hedhjen e votës së tyre, del qartë se gratë dhe burrat kërkojnë, në fund të fundit, kandidatin i cili është më i besuari, si dhe shohin edhe mandatin e partisë që përfaqëson kandidati.
- **Për pyetjen** "*Sipas mendimit tuaj, do të ishit dakord që një femër të mund të zgjidhet/emërohet në postin e mëposhtëm?*" Përgjigjet tregojnë se, në përgjithësi, njerëzit janë të hapur që femrat të jenë në poste të veçanta udhëheqëse—më konkretisht, në kujdesin social, shëndetësi dhe drejtësi. Megjithatë, kur bëhet parashikimi për gratë në postet më të larta (kryetar komune, kryeministër dhe president) në përgjigjet e tyre pjesëmarrësit ndihen më pak mirë me gratë në këto poste drejtuese. Është sidomos interesante të

vëresh se si pjesëmarrësit meshkuj edhe ato femra dhanë përgjigje shumë të ngjashme për këtë pyetje.

II. HYRJE

Sipas një studimi të kohëve të fundit nga UNIFEM, roli i grave në zgjedhje po rritet me shifra rekord, duke arritur një mesatare botërore prej 18,4 për qind të vendeve në asambltetë kombëtare dhe, në 22 vende, duke kaluar shifrën 30 për qind të vendeve në asambltetë kombëtare. Një element thelbësor i organizimit të grave në mbarë botën ka qenë përqendrimi i vëmendjes në proceset politike, në mënyrë që t'i jepet formë bërjes së politikave—me fjalë të tjera, gratë po i përdorin votat për të fuqizuar ndikimin e tyre.⁵

Kjo prirje botërore nuk është ndjerë ende në Shqipëri, ku roli i grave në jetën publike mbetet kryesisht i papranuar dhe pjesëmarrja e plotë dhe e barabartë e grave në vendimmarrje vazhdon të jetë e kufizuar për shkak të stereotipave të përhapura dhe praktikave diskriminuese. Kalimi nga socializmi në demokraci, në Shqipëri, ka pasur një efekt drastik në pozicionin e grave në shoqëri. Në regjimin komunist, gratë mbanin "barrën e dyfishtë" të përgjegjësisë si për jetën private ashtu edhe atë publike. Në sipërfaqe, duket sikur gratë konsideroheshin punëtore të barabarta, në sytë e shtetit, dhe shumica e grave ishin të punësuar në pozicione me kohë të plotë. Për më tepër, në qendrën e punës, gratë përballeshin me vështirësi nëse donin të ngriheshin në pozicione me kompetenca vendimmarrëse. Kjo barazi e perceptuar në jetën publike nuk shtrihej në jetën private. Pas pune, gratë ktheheshin në shtëpi, ku mbanin përsipër, të vetme, përgjegjësinë për t'u kujdesur për shtëpinë dhe për fëmijët.

Kalimi nga komunizmi në demokraci, pjesërisht, u shoqërua nga një thirrje për t'u kthyer vlerave "tradicionale" dhe kjo çoi, në një farë shkalle, që gratë të mënjanoheshin nga jeta publike dhe politike. Kjo vihej re më shumë në arenën politike, duke qenë se numri i grave në politikë ra në mënyrë rrënjësore në parlamentet e para të formuara në regjimin demokratik. Në kuvendin e parë pluralist (1991) vetëm 9 nga 250 deputetë (domethënë, 3,6%) ishin femra. Në kuvendin e mëpasshëm, vetëm 4 nga 140 deputetë (2,8%) ishin femra.⁶ Megjithatë, duhet theksuar se, gjatë regjimit komunist, Shqipëria kishte një përqindje relativisht të lartë të grave në politikë, por ato nuk ishin në poste vendimmarrëse apo me pushtet të plotë.

Edhe pas futjes së masave të posaçme për të siguruar pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje në Shqipëri, ka ende sfida të shoqërisë dhe të sistemit, të cilat e pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe të barabartë të tyre. Megjithatë, këto sfida nuk janë vetëm në Shqipëri. Sipas një grupi ekspertësh me qendër në Mbretërinë e Bashkuar, partitë politike nuk përpiqen t'u japin zgjidhje këtyre pengesave, të cilat një studim i kategorizon, në gjuhën angleze, si "katër C-të": besimi, kultura, kujdesi për fëmijët (domethënë, përgjegjësitë tradicionale të gruas në shtëpi) dhe

⁵ UNIFEM, "Përparimi i grave në botë, 2008/2009: Kush u jep llogari grave?: Gjinia dhe llogaridhënia", faqe 17, www.unifem.org/progress/2008

⁶ Projekt kërkimor: "Shqipëria në tranzicion: Roli dhe perspektiva e elitës", nga Dr Kosta Barjaba, fitues i bursës së NATO-s (individ), 1996-1998.

mjetet monetare (domethënë, investimi relativisht i pamjaftueshëm në fushatat e grave nga partitë politike).⁷

Gratë jo vetëm janë mënjanuar nga politika dhe partitë politike gjatë viteve '90, por ato ishin edhe të parat që humbën vendet e punës në reformat ekonomike të cilat u bënë në kuadër të tranzicionit drejt ekonomisë së tregut. Grave u është rritur vazhdimisht prekmëria për shkak të humbjes së burimeve thelbësore të mbrojtjes sociale nga shteti, gjë që ka ndodhur gjatë tranzicioni drejt ekonomisë së tregut. Është pakësuar mbrojtja sociale në lidhje me kujdesin shëndetësor dhe kujdesin për fëmijën. Këto ndryshime ekonomike dhe politike kanë krijuar një grup të ri pengesash, duke e bërë edhe më të vështirë për gratë të vendosin në drejtpeshim dëshirën e tyre për t'u angazhuar në sferën publike (përfshirë edhe politikën) me përgjegjësitë në rritje që kanë në sferën private.

Rritja e pjesëmarrjes politike të grave si kandidatë është një çështje e dhënies së mundësisë dhe një çështje të cilës i duhet dhënë zgjidhje në Shqipëri. Gjatë viteve '90, në Ballkan, masat e posaçme për pjesëmarrjen politike të grave nuk janë pritur mirë në fillim në ish-vendet komuniste, për shkak të faktit se njerëzit i lidhnin ato me të shkuarën komuniste. Megjithatë, duke qenë se gratë u ndërgjegjësuat sa të rrezikuara për përjashtim social po bëheshin, u rrit edhe mbështetja për politika të tilla. Siç duket se e tregojnë edhe të dhënat paraprake nga Bosnje-Hercegovina, Serbia dhe Maqedonia, masat e posaçme kanë pasur një efekt në mundësimin e futjes së grave në parlament, e megjithatë gratë politike janë ende larg posteve të qenësishme me pushtet vendimmarrës.

Në Shqipëri, viti 2008 ishte viti kur u miratua për herë të parë në vend kuota (norma e pjesëmarrjes) për gjininë më pak të përfaqësuar. Më konkretisht, Ligji "Për barazinë në shoqëri" (korrik 2008) parashikon që të paktën 30% e posteve të emëruara duhet t'i jepen gjinisë më pak të përfaqësuar. Ligji thotë gjithashtu se 30% e të gjithë kandidatëve të propozuar në zgjedhjet e përgjithshme dhe ato vendore duhet të jenë nga gjinia më pak e përfaqësuar. Duke u mbështetur në këtë inerci të fituar, mbrojtësit e barazisë gjinore në shoqërinë civile, qeveri (përfshirë edhe partitë politike) dhe bashkësinë ndërkombëtare punuan për të përfshirë një aspekt të këtyre dispozitave në Kodin Zgjedhor të miratuar rishtazi.⁸ Më konkretisht, kodi i ri thotë se në listat e partive kombëtare duhet të ketë kandidatë nga të dyja gjinitë në tri emrat e parë të listave të partive dhe/ose në secilën listë të aplikohet norma prej 30%. Në nivel vendor, norma prej 30% aplikohet duke përdorur "rendin e listës", që do të thotë se në çdo emra të listës njëri duhet të jetë patjetër nga gjinia më pak e përfaqësuar, derisa të jetë arritur norma prej 30% në listë.⁹

⁷ UNIFEM, "Përparimi i grave në botë, 2008/2009", faqe 23, www.unifem.org/progress/2008

⁸ Kodi Zgjedhor është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë më 29 dhjetor 2008.

⁹ Neni 67 (Lista e kandidatëve të partive dhe koalicioneve të partive)

"5 - Për çdo zonë zgjedhore, të paktën tridhjetë për qind e listës shumëmemërore dhe/ose një në tre emrat e parë të listës shumëmemërore duhet t'i përkasë secilës gjini. Për zgjedhjet e njësisive të administratës vendore, një nga tre emra në listë duhet t'i përkasë secilës gjini."

Megjithëse zgjedhjet parlamentare të vitit 2005 nxorën njërën prej pjesëmarrjeve më të mëdha të grave në zgjedhje si kandidatë për deputete, në fund të zgjedhjeve, Shqipëria pati njërin prej numrave më të vegjël të deputeteve femra në Evropë dhe të femrave në administratën publike. Gratë në parlament kanë vetëm diçka më shumë se 7% të vendeve. Sipas një studimi të Unionit Ndërparlamentar, Shqipëria ndodhet në vendin 116 nga 187 vende, dhe në vend të fundit në krahasim me vendet e tjera të Evropës Juglindore.¹⁰ Në zgjedhjet vendore të vitit 2007, vetëm 33 prej 1.073 kandidatëve të propozuar për kryetarë të bashkive dhe komunave ishin gra dhe, nga këto, vetëm 9 u zgjodhën. Në postet e larta vendimmarrëse, gratë nuk janë të përfaqësuara mirë dhe në vitin 2008 ka vetëm dy ministre femra. Ka pasur përparime: për shembull, kryetari i kuvendit, prokurori i përgjithshëm dhe kryetari i gjykatës së lartë janë femra.¹¹ Krahas kësaj, shumë parti politike kanë përdorur norma pjesëmarrjeje në asambljetë e përgjithshme të tyre.

Sipas sondazheve, të dhënave dhe raporteve të ndryshme, del se përfaqësimi mesatar i grave në kuvendet kombëtare të BE-së ishte 25% në vitin 2005 dhe arriti 17% në shtetet anëtare të Evropës Qendrore dhe Lindore.¹² Arsyet kryesore për këtë mungesë drejtpeshimi sipas politikaneve femra ishte mungesa e kohës, besimi i ulët te vetja dhe rritja e përgjegjësisë në familje si edhe perceptimi i rolit që duhet të luajë gruaja në shoqëri. Gratë të cilat dëshirojnë një karrierë politike lihen jashtë rrjeteve politike dhe u duhet të luftojnë vazhdimisht stereotipat që lidhen me rolin e tyre në shoqëri. Ekziston perceptimi se ka një parapëlqim që meshkujt të jenë udhëheqës politikë, ndërsa ato gra që vendosin të hyjnë në politikë shikohen si gra jo të zakonshme dhe, për rrjedhojë, u duhet të dëgjojnë komente jo të favorshme për jetën e tyre vetjake dhe familjare, të cilat nuk thuhet për politikanët meshkuj.

Siç e tregojnë rezultatet e këtij vrojtimi, edhe në Shqipëri ekziston një situatë e ngjashme. Përpara miratimit të kuotës në vitin 2008, ka pasur një numër të kufizuar të grave të cilave u jepet mundësi nga partitë apo bashkësitë për të fituar përvojë politike. Një faktor tjetër i cili e shkakton këtë situatë është se shumë gra e shikojnë politikën si një "punë të pisët" dhe si një punë më shumë për meshkuj. Ky perceptim është i përhapur në bashkësinë e grave, çka shkaktohet edhe nga mungesa e mundësive për punësim pas ndryshimeve në sistemin politik, standarde "agresive" të trashëguara nga periudha e komunizmit për hyrjen në politikë dhe ndryshimet e bëra në institucione të rëndësishme, siç janë: besimi fetar, familja, etj. Pozicioni social dhe politik i grave është nën trysni dhe sjelljet diskriminuese janë ende të dukshme si rezultat i ndryshimeve në sistem.

¹⁰ Raporti mbi gratë në politikë, për situatën më 1 janar 2008, përgatitur nga Unioni Ndërparlamentar (IPU) dhe Divizioni për Përparimin e Grave i Kombeve të Bashkuara, me rastin e seancës së 52-të të Komisionit për Statusin e Grave të Kombeve të Bashkuara.

¹¹ 5, nga 15, anëtarë të Gjykatës së Lartë janë femra, <http://www.gjykataelarte.gov.al/anetaret.htm>

¹² Projekti "Zgjerimi, Çështjet Gjinore dhe Qeverisja", seminar ndërkombëtar në Parlamentin Evropian, ku janë paraqitur konstatimet kryesore të studimit të financuar nga Komisioni Evropian në 8 shtete anëtare në Evropën Qendrore dhe Lindore, përfshirë Bullgarinë dhe Rumaninë, në lidhje me rolin dhe pjesëmarrjen e grave në vendimmarrjen politike, "European Commission Research", Press 2006, mund ta gjeni në adresën: <http://ec.europa.eu/research/press/2006/pr0903en.cfm>

Mirëpo, mbrojtësit e barazisë gjinore kanë zbuluar se rezultate të tilla pozitive si rritja e pjesëmarrjes së grave në jetën publike nuk arrihen thjesht duke shtuar numrin e grave në strukturat e vendimmarrjes publike, edhe pse kjo është e rëndësishme. Varfëria, mungesa e shërbimeve të kujdeseve sociale, prekshmëria nga shfrytëzimi dhe dhuna dhe përjashtimi social për shkak të normave dhe stereotipave të gjitha e pengojnë pjesëmarrjen e grave në jetën publike.

Po aq të nevojshme janë përpjekjet për të përmirësuar "kërkesën" nga gratë për qeverisje më të mirë. Gratë duhet të aftësohen për të kërkuar shpjegime nga aktorët publik kur këta nuk arrijnë t'i parandalojnë shkeljet e të drejtave të grave. Gratë lipset të bashkohen si forcë politike, si grup votuesesh, për të kërkuar barazi gjinore dhe përmirësim të standardeve të jetesës.

Që të arrihet një ndryshim i qëndrueshëm dhe me kuptim, për të nxitur barazinë gjinore në sistemet zgjedhore dhe vendimmarrjen publike, do të duhet që:

- Partitë të përfshijnë barazinë gjinore në platformat e fushatave të tyre dhe programeve legjislative;
- Partitë të propozojnë si kandidatë mbrojtës të fuqishëm të barazisë gjinore (si kandidatë meshkuj, ashtu edhe kandidatë femra);
- Të shpërndahet informacion i mjaftueshëm për votuesit, në lidhje me rrjedhojat që kanë për barazinë gjinore propozimet e partive;
- Gratë të veprojnë si një grup i efektshëm zgjedhësesh, që kërkojnë barazi gjinore dhe llogaridhënie. Me fjalë të tjera, gratë të jenë votuese aktive dhe të jenë të angazhuara në diskutimet rreth votimeve;
- Gratë të cilat sigurojnë pozicione të larta politike të sjellin ndryshimin në lidhje me çështje të lidhen me barazinë gjinore dhe të bëjnë aleatë tek meshkujt me të cilët punojnë.

Vrojtimi për çështjet e pjesëmarrjes së grave në zgjedhje është pjesë e një nisme më të madhe të mbështetur nga UNIFEM në Shqipëri, në mbështetje të grave për t'u kërkuar llogari vendimmarrësve dhe për të fuqizuar idenë e grave si forcë politike, një forcë politike që merr pjesë në zgjedhje me një zë specifik, që duhet të transmetohet përmes votës së tyre si edhe përmes kandidaturës së tyre dhe zgjedhjes.

III. METODIKA E VROJTIMIT DHE KUFIJTË E GABIMIT

Ky vrojt看 është përgatitur nga Qendra Shqiptare për Studime Ekonomike (ACER) dhe Forumit Social Ekonomik Shqiptar (ASET), dhe përqendrohet në dy çështje kryesore: (1) vrojtimi i praktikave të votimit përmes një thjerre gjinore—për të kuptuar se si dhe përse votojnë burrat dhe gratë; dhe (2) perceptimet e njerëzve në lidhje me pjesëmarrjen e grave në zgjedhje si votuese dhe si kandidatë, si edhe në lidhje me vendosjen e tyre në poste vendimmarrëse. Vrojtimi "Perceptimi publik i pjesëmarrjes së grave në zgjedhje" synon të ofrojë informacion për vendimin e votuesve në lidhje me pozicionin zgjedhor të grave. Ky është një vrojt看 kampion. Për këtë arsye, ky dokument ofron informacion vetëm për çështjet kryesore të angazhimit zgjedhor të tyre dhe perceptimit të votuesve në lidhje me këtë angazhim; vlerësimin e arsyeve dhe pengesave për një pjesëmarrje dhe përfaqësim më aktiv të grave në politikë; disa vlerësime për pritshmëritë e votuesve në lidhje me rritjen e mundshme të pjesëmarrjes së grave në politikë; një vlerësim për faktorët e grupeve që ndikojnë në pjesëmarrjen e grave dhe angazhimin e tyre në bashkësi, si edhe disa të dhëna demografike, si për shembull: besimi fetar, dinamika e statusit ekonomik, niveli i ndërthurur i arsimit dhe moshës me angazhimin publik të grave.

Ky vrojt看 nuk i trajton çështjet konkrete të lidhura me përkatësinë etnike. Një version i plotë të kësaj baze të dhënash do të publikohet në hapësirën në internet, që mund të përdoret nga personat e interesuar.

Pyetësori i vrojtimit përbëhet nga 45 pyetje (Aneksi I). Në vijim jepet një pjesë e konstatimeve të ndryshoreve të cilat mund t'i interesojnë një auditori të gjerë në funksion të objektivave të lartpërmendur të projektit.

Intervistat janë zhvilluar më 10-24 nëntor 2007, me 1,300 qytetarë shqiptarë mbi 18 vjeç, të cilët janë përzgjedhur në mënyrë të rastësishme. Intervistat janë bërë ballë për ballë, dhe secila intervistë ka zgjatur për rreth 30 minuta. 60% e intervistave (ose 708) janë bërë në gjashtë qytete kryesore të vendit, të shpërndarë në 83 njësi kampioni (Njësi Parësore Kampioni). (Shih Tabelën më poshtë). Pjesa tjetër, apo 460 intervista, janë mbajtur në qytete të tjera të shpërndara në 90 njësi kampion. Gjetjet e vrojtimit, me nivel besimi prej 95%, kanë një saktësi statistikore prej $\pm 2,2$ të rezultateve të cilat mund të nxirren nëse do të ishin intervistuar të gjithë shqiptarët mbi 18 vjeç.

Tabela 1: Zbërthimi i intervistave sipas gjinive

		Gjinia e personit të intervistuar		
Qyteti	Zona	Femra	Meshkuj	Gjithsej
Burrel	fshat	5	9	14
	qytet	8	5	13
Gramsh	fshat	6	8	14
	qytet	4	3	7

Korçë	fshat	24	33	57
	qytet	37	17	54
Krujë	fshat	4	8	12
	qytet	7	7	14
Kukës	fshat	10	18	28
	qytet	9	5	14
Lezhë	fshat	18	16	34
	qytet	6	8	14
Lushnjë	fshat	30	33	63
	qytet	16	19	35
Mirditë	fshat	7	7	14
	qytet	3	4	7
Peshkopi	fshat	11	16	27
	qytet	3	2	5
Sarandë	fshat	13	13	26
	qytet	10	10	20
Shkodër	fshat	38	25	63
	qytet	41	29	70
Skrapar	fshat	6	8	14
	qytet	1	4	5
Tiranë	fshat	23	22	45
	qytet	197	177	374
Vlorë	fshat	21	28	49
	qytet	42	34	76
Gjithsej		600	568	1168

Shumica e gjetjeve të futura në këtë raport përfaqësojnë përqindjen kundrejt numrit gjithsej, në përputhje me alternativat e vlerësuara nga personat e intervistuar, ndërsa një pjesë e tyre jepen si vlerësim nga 1 deri në 5 ("shumë i vogël" deri në "shumë i madh" ose "nuk jam aspak dakord" deri në "jam dakord"). Synimi i këtij vlerësimi ishte të merret një njohuri më e mirë nga auditori i këtij raporti. (Për shembull: P12: Si do t'i vlerësonit të ardhurat e familjes suaj gjatë këtij viti, në krahasim me vitin 2006? 1=Janë rritur shumë, 2=Janë rritur, 3=Nuk kanë ndryshuar, 4=Kanë rënë, 5=Kanë rënë shumë, 99=Nuk pranoj të përgjigjem)

Është përdorur kjo shkallë vlerësimi për të kërkuar mendimin e pjesëmarrësit në thellësi. Analiza e të dhënave është bërë në bazë të mesatares së rezultateve, në mënyrë që t'i jepet mundësi lexuesit ta kuptojë tërësisht perceptimin e atyre që u janë përgjigjur pyetjeve.

IV. SI DHE PËRSE VOTOJNË FEMRAT DHE MESHKUJT?

Këto pyetje kanë për synim të gjejnë, brenda vrojtimit, nëse dhe si mund ndryshojnë qasjet e meshkujve dhe femrave sa i takon votimit. Është e rëndësishme të theksohet se vrojtimi nuk ka parë përkatësinë partiake apo se për cilën parti kanë votuar pjesëmarrësit në vrojtim në zgjedhjet e mëparshme.

Historikisht, vota e qytetarëve është një prej mjeteve më të fuqishme përmes të cilave u kërkojnë llogari vendimmarrësve. Është e rëndësishme të theksohet se perceptimi i njerëzve për institucionet politike dhe besimi i tyre te këto institucione ka ushtruar ndikim në përgjigjet e tyre në këtë vrojtim. Në krahasim brendapërbrenda Evropës, shqiptarët kanë një nivel relativisht të lartë zhgënjimi me politikën dhe proceset politike.¹³


Në vijim jepen përgjigjet dhe gjetjet nga pyetjet e bëra në lidhje me si-në dhe pse-në e votimit të meshkujve dhe femrave.

Pjesëmarrja si votues:

Kur u pyetën femrat dhe meshkujt për pjesëmarrjen e tyre në votim, përgjigjet treguan se kishte një pjesëmarrje më të madhe të votuesve në zgjedhjet vendore sesa në zgjedhjet e përgjithshme: 79% votuan në zgjedhjet vendore, në krahasim me 71% në zgjedhjet e përgjithshme.¹⁴ Në nivel vendor, votuan më shumë meshkuj se femra, arsyet për të cilën do të shikohen më poshtë.

Pyetje: A votuat në zgjedhjet vendore të datës 18 shkurt 2007?


Grafiku 1: Votimi në zgjedhjet e vitit 2007



¹³ IDRA – “Korrupsioni në Shqipëri, perceptime dhe përvoja (2008)”, (Vrojtim 2005), Instituti për Studime Bashkëkohore, Raport i Shërbimeve Kërkimore mbi Zhvillimin e Kapacitetit të Administratës Publike, mars 2008

¹⁴ Megjithatë, rezultatet e pjesëmarrjes së qytetarëve në zgjedhjet parlamentare, sikurse përshkruhet në Grafikon 3 tregojnë një nivel pjesëmarrjeje më të lartë se pjesëmarrja e raportuar gjatë zgjedhjeve në fjalë. Kjo vjen si rezultat i faktit se shumica e qytetarëve, në kohën kur është zhvilluar vrojtimi, nuk kishin qenë në Shqipëri, shumica e tyre kanë qenë të punësuar përkohësisht jashtë vendit, në mënyrë të ligjshme ose jo, në vendet e Bashkimit Evropian dhe në vende të tjera të botës, për të mos përmendur, për më tepër, intensitetin e këtij procesi, kryesisht në Greqi (punësim i paligjshëm) dhe Greqi, Itali, Gjermani, etj., (kryesisht punësim i ligjshëm), gjatë periudhës në fjalë.

Grafiku 2: Pjesëmarrja e votuesve në zgjedhjet vendore të datës 18 shkurt 2007



P3: A votuat në zgjedhjet parlamentare të datës 3 korrik 2005?

Tabela 2: Votuesit të cilët nuk votuan në zgjedhjet parlamentare të datës 3 korrik 2005

	Femra	%	Meshkuj	%	Gjithsej	Femra/Gjithsej	Meshkuj/Gjithsej
fshat	60	32.1%	56	41%	116	51.7%	48.3%
qytet	127	67.9%	81	59%	208	61.1%	38.9%
Gjithsej	187	100.0%	137	100%	324		

Përqindja e femrave të cilat nuk votuan është më e lartë se meshkujt, si në fshat ashtu edhe në qytet. Megjithatë, numri i femrave që nuk votuan ishte më i madh në qytet se në fshat, sidomos po ta krahasosh me raportin e meshkujve në qytet dhe fshat, siç e tregon edhe Tabela 2.


Arsyet për mospjesëmarrje në votim:

Ndërkohë që, nga përgjigjet, del qartë se meshkujt janë më të predispozuar për të votuar, raporti i votuesve meshkuj-femra nuk ndryshon shumë. Megjithatë, aty ku dalin më në pah dallimet midis gjinive, janë arsyet e mospjesëmarrjes në votim. Sikurse e tregojnë tabelat më poshtë, përqindja e pjesëmarrësve në vrojtim të cilët nuk votuan ishte më e lartë më 3 korrik 2005 sesa më 18 shkurt 2007. Sikurse e tregon edhe grafiku më poshtë, arsyet kryesore për mos-votim ishin: nuk u pëlqenin kandidatët (30,2%); nuk e kishin emrin në listën e votuesve (21,9%); dhe se nuk votoi askush në familjen e tyre (18,1%), sidomos në fshat. Vetëm 0,3% thanë se nuk votuan ngaqë kandidatja ishte femër.

Tabela 3: Pjesëmarrësit në vrojtim të cilët nuk votuan në zgjedhjet e mëparshme

	03.07.2005	18.02.2007
Jo	324	389
Gjithsej	1168	1168
Jo/gjithsej në %	27.7%	33.3%

Grafiku 3: Arsyet kryesore për mospjesëmarrjen në votim



Kur i zërthejmë këto përgjigje sipas gjinive, dalin qartë dallimet midis gjinive sa i takon qasjes për votimet. Për femrat, arsyeja kryesore e mosvotimit ishte se **nuk ishin të regjistruara në listën e votuesve** (24,90%); ndërsa këtë përgjigje e dhanë vetëm 17,40% e meshkujve pjesëmarrës në vrojtim. Për të dyja gjinitë, këto janë raporte njësoj të larta dhe lënë të kuptosh problemet me listat e votuesve në zgjedhjet e përgjithshme (2005) dhe ato vendore (2007). Megjithatë, kjo përqindje mbetet shumë më e lartë për femrat, çka tregon se nuk janë regjistruar si duhet në bazat e të dhënave nga të cilat janë nxjerrë listat e votuesve dhe/ose nuk kanë qenë në dijeni të procesit të verifikimit të vlefshmërisë së të dhënave në listat e votuesve menjëherë përpara zgjedhjeve. Nevojitet më shumë punë kërkimore për të kuptuar më mirë vështirësitë e mundshme të lidhura me gjininë, të cilat vijnë nga sistemi i gjendjes civile në Shqipëri. Në të shkuarën prirja ka qenë që të regjistrohen familjet, dhe kështu, personi i futur më shpesh në listë është kryefamiljari, që është kryesisht mashkull. Një shpjegim tjetër alternativ është se kur martohet një çift, procesi tradicionalisht ka qenë që është mashkulli ai që e regjistron martesën dhe, kështu, krijon një familje të re në regjistrat e gjendjes civile. Nëse nusja shkon në shtëpinë e dhëndrit, nga një rreth tjetër, ajo mund të jetë e regjistruar në zonën zgjedhore ku jeton tani. Ka një numër variacionesh të ndryshme arsyetimi për këtë mungesë të regjistrimit të femrave, dhe, për këtë, lipset më shumë punë kërkimore.


Një prej gjetjeve të vrojtimit që lidhet më shumë me çështjet është se si funksionon **votimi familjar** në Shqipëri, sidomos në lidhje me mënyrën si përcakton pjesëmarrjen e femrave si votuese. Nga ata që nuk kanë votuar, 23,10% e femrave dhe 10,40% e meshkujve nuk votuan sepse as familjet e tyre nuk votuan. Këto shifra tregojnë qartë se femrat kanë më pak gjasa se meshkujt të jenë të angazhuara politikisht, nëse familjet e tyre vendosin të mos angazhohen. Votimi si familje nuk është ndonjë dukuri e re në Shqipëri, madje nuk është i papërsëritur në Ballkan. Procesi i votimit familjar nuk është i studiuar mirë në Shqipëri, por, po të shohësh përgjigjet në vrojtimit, duket qartë se ka tri aspekte të votimit familjar, nëse e sheh përmes thjerrës gjinore:

- a) **Votimi familjar fillon me regjistrimin.** Ka nevojë për më shumë punë kërkimore për të kuptuar se përse femrat kanë më shumë gjasa të mos jenë të regjistruara si duhet në listat e votuesve, por siç e tregon edhe analiza e mësipërme, kjo lidhet me vlefshmërinë e regjistrimit të tyre në gjendjen civile. Ka të dhëna se për shumë femra, regjistrimi i tyre shpesh bëhet nga bashkëshortët e tyre, me prokurë, ose në nivel familje (kryefamiljar i së cilës është bashkëshorti apo babai) dhe jo në nivel individual;
- b) **Pjesëmarrja në votim:** Në mbarë botën në zhvillim, monitoruesit e zgjedhjeve flasin për të dhënat se ka votim familjar në kabinat e votimit ditën e zgjedhjeve, për të përzgjedhur kandidatët. Megjithatë, del qartë nga shifrat më lart se votimi familjar fillon në shtëpi dhe, shpesh, perceptohet si një akt i përfaqësimit të interesit dhe/ose statusit të familjes. Nëse familja e një femre nuk shkon të votojë ditën e zgjedhjeve, atëherë ka të ngjarë që as ajo të mos shkojë të votojë dhe do t'i thonë që të mos shkojë të votojë, çka do të thotë se ajo do të çojë dëm njërin prej mjeteve që ka për t'u kërkuar llogari vendimmarrësve.
- c) **Vendimi se si do të votojë ajo:** Siç e tregojnë edhe tabelat në vijim, nga ata që votojnë dhe marrin asistencë, burimi kryesor i "asistencës" për femrat është familja e tyre, kur hedhin votën. Pra, koncepti i shqyrtimit të platformave të partive (kur ka të tilla) dhe vlerësimi se si vendimmarrësit i kanë mbështetur programet/politikat dhe shërbimet që plotësojnë nevojat specifike të saj është diçka e re për shumë femra, dhe mbase, edhe për shumë meshkuj. Megjithatë, femra si përfaqësuese e familjes së saj (dhe shpesh, një përfaqësuese me pak pushtet) mund të ketë më shumë gjasa për të votuar në favor të interesit të familjes së saj se në interesin e vet.


Gjithashtu është interesante të theksohet se për meshkujt, arsyeja kryesore pse nuk votojnë (40%) ishte arsye politike: nuk u pëlqenin kandidatët, në krahasim me vetëm 23,70% të femrave. Këto shifra, në fillim, do të çonin në një përfundim, që femrat nuk janë edhe aq të interesuara për politikën dhe proceset politike, sa edhe burrat. Megjithatë, kjo hipotezë kundërshtohet nga fakti që për femrat të cilat nuk kanë votuar, mospëlqimi i kandidatëve ishte arsyeja e dytë kryesore (23,70%), çka lë të kuptosh që femrat, në të vërtetë, i ndjekin proceset zgjedhore dhe dialogun zgjedhur, më shumë nga sa supozojnë perceptimet

tradicionale. Ndërkohë 25,20% e meshkujve në vrojtim nuk votuan, sepse nuk e kishin mbushur moshën 18 vjeç në datën e zgjedhjeve.

Grafiku 4: Arsyeja për mos-votim




Grafiku 5: A keni qenë dëshmitarë të votimit në familje/në grup?



Të dhënat e paraqitura në grafikun 5 tregojnë se një numër i konsiderueshëm qytetarësh (23%) e kanë vënë re dukurinë e votimit në grup (në familje).


Përkundër gjetjeve sa më lart, është interesante të theksohet se pyetjes nëse kishte ndonjë pengesë për femrat për të votuar (grafiku 6, më poshtë), 60% e personave iu përgjigjën "jo".

Grafiku 6: Vlerësimi i pengesave ndaj pjesëmarrjes së femrave si votuese



Hedhja e votës suaj:


Grafiku 7: Votimi me asistencën e një të treti




Siç e tregon edhe grafiku më lart, 9,6% e personave që kishin votuar u përgjigjën se ishin asistuar në një mënyrë a një tjetër kur kishin hedhur votën, që do të thotë e kanë hedhur votën në praninë e një të treti. Ky i tretë mund të jetë një familjar; ose një anëtar i komisionit zgjedhor në qendrën e votimit ose mbase një përfaqësues i një partie politike që vëzhgon zgjedhjet. Ky grup mund të përfshijë persona të cilët kanë përkatësi partiake dhe u shërbejnë grupimeve partiake që marrin pjesë në zgjedhje, por, në çdo rast, ata nuk janë të autorizuar dhe kjo bie ndesh me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me Kodin Zgjedhor.

9,6% e atyre që kanë votuar dhe që kanë pasur asistencë gjatë votimit duhen analizuar për të parë shpërndarjen në fshat dhe qytet. Siç duket edhe nga grafiku 8, shpeshësia e kësaj dukurie është 1,6 herë më shumë në fshat se në qytet.

Grafiku 8: Shtrirja e asistencës gjatë votimit




Grafiku 9: Grupet që asistojnë votuesit



Nga të dhënat e Grafikut 6 është e qartë se krahas angazhimit në një nivel të konsiderueshëm (48,4%) të anëtarit të familjes të justifikuar ndonjëherë (në rastin e të moshuarve, personave me aftësi të kufizuara, personave me pak arsim, rasteve të qytetarëve që votojnë për herë të parë, kryesisht në fshat, etj.) ka edhe një numër personash që influencohen, sidomos femra, nga kryefamiljarët, gjatë përzgjedhjes së kandidatëve. Një numër i konsiderueshëm i votuesve asistohen nga anëtarët e Komisionit Vendor të Zgjedhjeve gjatë votimit. Ky angazhim justifikohet me plotësimin e detyrimit ligjor nga ana e tyre. Mirëpo, është e rëndësishme të tregohet kujdes që të trajtohen anëtarët e KQV-se si ta japin këtë asistencë dhe si të monitorojnë prevalencën e votimit familjar.

Grafiku 10: Hedhja e votës suaj



Ka më shumë të ngjarë që përqindja e lartë e femrave që asistohen të lidhet me dukurinë e votimit familjar, por, mbase, edhe me faktin se femrat mund të frikësohen më me lehtësi nga jofamiljarë gjatë votimit.


Siç duket edhe në Grafikon 10, qasja që mbizotëron është rasti "Më tregojnë si të votoj" (66,2%), një rezultat i cili të jep përshtypjen se personat (familjarët, anëtari i Komisionit Zgjedhor në qendrën e votimit, etj.) që ofrojnë këtë asistencë ushtrojnë funksionin e arritjes së procesit të votimit. Por këtë rezultat e kompromenton fakti se një përqindje relativisht e lartë e rasteve në votim me ndihmën e personave të tretë (25%) jo vetëm që janë të shoqëruar në dhomën e fshehtë por edhe u thonë si të mësojnë, ku rasti më i paligjshëm është kur u sugjerojnë se për cilin ta hedhin votën.¹⁵

	Femra	Meshkuj	Gjithsej
Më tregojnë si ta hedh votën	32	20	52
Më shoqërojnë në kabinën e votimit dhe më sugjerojnë si të votoj	11	10	21
Më tregojnë se për cilin të votoj	4	2	6
Nuk pranojnë të përgjigjen	6	5	11
Gjithsej	53	37	90

¹⁵ Raport i Komitetit Shqiptar të Helsinkit "Edukimi publik dhe vëzhgimi i Zgjedhjeve Vendore 2000". Në bazë të Nr. 98 të Kodit Zgjedhor, zgjedhësi pasi pajiset me fletën e votimit hyn për të votuar në dhomën e fshehtë. Kjo dispozitë e kodit në shumicën e rasteve është shkelur pasi është konstatuar votimi familjar, kryesisht i bashkëshortëve së bashku, prindërve me fëmijët, si dhe në disa raste votimi jashtë dhomës së fshehtë. Shpesh është pretenduar se zgjedhësi voton për herë të parë dhe ka vështirësi në votim. Faqe 15, 20 dhe 23.


Për cilin votoni—motivimet:

Grafiku 11: Motivimi i qytetarëve për përzgjedhjen që kanë bërë në zgjedhjet e fundit




Në bazë të këtij vrojtimi, pikat e mëposhtme përbëjnë çështjet kryesore në lidhje me përzgjedhjen e kandidatëve.

Grafiku 12: Çështjet kryesore për qytetarët




Është interesante të vëresh se meshkujt dhe femrat u jepnin përparësi, në përgjithësi, të njëjtave problemeve, si energjia, uji, kujdesi shëndetësor dhe sistemi social. Divergjenca ka në lidhje me çështjet e arsimit (femrat vendosin një theks më të madh në këtë çështje) dhe korrupsionit (meshkujt vendosin një theks më të madh në këtë çështje).

Grafiku 13: Çështjet kryesore nga këndvështrimi i votueseve femra



Grafiku 14: Çështjet kryesore nga këndvështrimi i votuesve meshkuj




Pjesëmarrja si votues në zgjedhjet e ardhshme:

Duke pasur parasysh stereotipat tradicional që marrin si të qenë mungesën e interesit nga ana e grave shqiptare kur vjen puna te politika, është interesante të vëresh se si meshkujt ashtu edhe femrat e pyetur, shumica e tyre, thanë se do të votonin në zgjedhjet e ardhshme.

Megjithatë, është më e madhe përqindja e femrave “të pavendosura” nëse do të votojnë apo jo. Lexuesi nuk duhet të nxjerrë përfundimin se kjo pasiguri lidhet me mungesë interesi për politikën (duhet më shumë punë kërkimore për të kuptuar burimin dhe logjikën e kësaj pasigurie), mbase zhgënjim nga sistemet qeverisëse apo besimi se kryefamiljari do ta përfaqësojë votën e saj me drejtësi dhe siç duhet ditën e zgjedhjeve.

Grafiku 15: Pjesëmarrja në zgjedhjet e ardhshme, me shpërndarjen sipas gjinive




	Femra	Femra	Meshkuj	Meshkuj	Gjithsej
Nuk do të votoj	53	62%	33	38%	86
Mbase nuk do të votoj	42	58%	31	42%	73
Mbase do të votoj	164	53%	146	47%	310
Do të votoj	242	47%	270	53%	512
Nuk e di nëse do të votoj apo jo	96	53%	85	47%	181
Nuk pranojnë të përgjigjen	3	50%	3	50%	6
Gjithsej	600	51%	568	49%	1.168

V. FEMRAT DHE MESHKUJT SI ZYRTARË TË ZGJEDHUR DHE TË EMËRUAR

Në këtë rubrikë, do të shikojmë se cilat janë perceptimet e femrave dhe të meshkujve në lidhje me femrat si kandidatë dhe femrat si vendimmarrëse. Siç do ta shohë edhe lexuesi, ka shtresa të shumëfishta përgjigjesh në kundërthënie, në raport me perceptimin e njerëzve për të drejtën e femrave për të qenë kandidatë në zgjedhje, rolin e tyre në parti dhe efektivitetin e tyre kur zgjidhen në post.

Një prej gjetjeve më të rëndësishme, që tregohet në grafikun 16 është se, në përgjithësi, shumica e pjesëmarrësve në vrojtimit (73,4%), burra dhe gra, mendojnë se ka nevojë për ta rritur praninë e grave në jetën publike.

Grafiku 16: Pranimi/mospranimi i rritjes së pranisë së grave në jetën publike



Përkundër kësaj mbështetjeje të përgjithshme, përgjigjet më poshtë tregojnë, gjithashtu, se edhe pse nuk ka shumë rezistencë kundër grave për të qenë në poste vendimmarrëse, ka ende një pakicë të konsiderueshme që mendon se, brenda partive politike, gratë nuk do ta kenë mbështetjen e nevojshme për të përmbushur mandatet e tyre si zyrtare të zgjedhura apo të emëruara.

Përgjigjet tregojnë qartë se zyrtaret femra (të zgjedhura apo të emëruara) perceptohen si më pak të korruptuara dhe më shumë të predispozuar për të përmirësuar të drejtat e njeriut, përfitimin nga shërbimet elementare (shëndetësia, arsimiti, kujdesi social) dhe për të rritur mundësitë e Shqipërisë për integrim në BE.

Megjithatë, me gjithë mbështetjen e fuqishme për rritjen e rolit të grave në jetën publike, mbështetja për masat e posaçme/normat e pjesëmarrjes mbetet e vakët, të dyja gjinitë, për një sërë arsyes. Në shumë vende ish-komuniste, normat e pjesëmarrjes shpesh shihen si relikte të shpërdoruar të së shkuarës, që bien ndesh me idenë se përparimin në shoqëri duhet ta fitosh vetë. Për të tjerët, çdo formë "diskriminimi pozitiv" është e padrejtë. Për më tepër, ekziston ideja mes disa grave se norma e

pjesëmarrjes mund të shihet si "dhuratë nga meshkujt", që, de facto, mund të shihet si ulje. Megjithatë, kuptohet gjithnjë e më shumë se masat e posaçme janë një mënyrë për të drejtpeshuar një fushë loje shumë të pabarabartë. Në Shqipëri meshkujt janë në një numër shpërpjestimor më të madh se femrat në poste publike dhe në poste vendimmarrëse. Të dhënat globale tregojnë se normat e pjesëmarrjes dhe masat e posaçme janë një prej hapave më të rëndësishëm që mund të bëjë një shtet për të pasur një rritje të ndjeshme të numrit të femrave të zgjedhura dhe të emëruara në poste në nivel qendror dhe vendor.


Statistikat globale tregojnë gjithashtu se, përkundër normave të pjesëmarrjes, një prej pengesave të vetme më të mëdha për suksesin e femrave në politikë është mungesa e mbështetjes (financiare dhe strategjike) nga ana e vetë partive politike. Rrjedhimisht, partitë politike luajnë njërin prej roleve më të rëndësishme për ndryshimin e perceptimeve të shoqërisë në lidhje me femrat si udhëheqëse dhe si ligjvënëse.

Duhet theksuar se në kohën kur është bërë ky vrojtim (nëntor 2007), nuk ishin miratuar ende Ligji "Për barazinë gjinore në shoqëri" (korrik 2008) apo Kodi Zgjedhor, i miratuar rishtazi (dhjetor 2008), dhe normat e pjesëmarrjes nuk ishin ende të detyrueshme për partitë politike dhe për autoritetet. Është e rëndësishme të mos harrohet se këto masa konsiderohen të përkohshme gjersa të vijë koha që të ketë një përfaqësim më të barabartë në postet vendimmarrëse. Veç kësaj, pas disa muajve është ndryshuar edhe Kushtetuta, duke e kaluar sistemin, kështu, në një sistem me përfaqësim proporcional. Nga ana statistikore, sistemi me përfaqësim proporcional favorizon çuarjen përpara të grave dhe shoqërimi i këtij sistemi me normat e pjesëmarrjes të vendosura për herë të parë në vend, për gjininë më pak të përfaqësuar, është një shans shumë i mirë për çuarjen përpara të grave në vendimmarrje.

Gratë në postet e emëruara

Të dhënat më poshtë tregojnë se, në përgjithësi, shumica e atyre që u janë përgjigjur pyetjeve (84,4% e grave dhe 61,7% e burrave) e mbështesin idenë që gratë të emërohen në poste vendore dhe qendrore. Nuk është habi që për këtë ide rezistenca më e madhe vjen nga meshkujt, për arsyet që shikohen, më poshtë, në këtë vrojtim. Ajo që është interesante është niveli i lartë i pasigurisë si te meshkujt ashtu edhe te femrat (por, më shumë te meshkujt), në lidhje me vendosjen e femrave në poste të emëruara. Të dhënat më lart tregojnë një mbështetje të madhe për femrat në poste vendimmarrëse, mirëpo kur pyetjet e vroitimit kalonin në një nivel më të imët në lidhje me rolet specifike/postet, pasiguria rritet.


Grafiku 17: Shkalla në të cilën postet e emëruara duhet të përfaqësohen nga femra




Normat e pjesëmarrjes dhe masat e posaçme

Sikurse thuhet edhe më lart, siç e tregon edhe grafiku më poshtë, përgjigjet e mbështetnin idenë e kuotave (normave të pjesëmarrjes) dhe masave të posaçme (48%). Siç mund të kuptohet, ka më shumë femra (46,30%) se meshkuj (36%) që e mbështesin idenë e masave të posaçme, megjithatë ajo që është interesante dhe e rëndësishme të vëresh është niveli i lartë i rezistencës dhe/ose pasigurisë për konceptin nga ana e të dyja gjinive: 34,7% e femrave kundrejt 46,10% e meshkujve.

Grafiku 18: Rregullat për përqindjen e përfaqësimit të femrave në politikë




Grafiku 19: Pranimi/mospranimi i normave legislative mbi përqindjen minimale të kandidatëve femra në zgjedhje



Grafiku më poshtë tregon perceptimin e masave të posaçme për femrat në postet e emëruara, duke treguar se mbështetja në këtë nivel është edhe më e ulët (41,40%), dhe për postet e zgjedhura (48%). Kjo mund të jetë sepse shumë veta i perceptojnë postet e emëruara si poste me pushtet të qenësishëm, dhe, kështu, kur hidhet ideja e vendosjes me ligj të rritjes së angazhimit të femrave, ka një ngurrim për ta bërë me ligj ndryshimin e status kuos. Ky ngurrim mund të mbështetet në stereotipat tradicional të femrave, si nëna dhe kujdestare, e jo si njerëz që mund t'i japin formë terrenit politik dhe shoqëror të kombit. Duhet thënë se këto konstatime janë shumë të ngjashme si në fshat ashtu edhe në qytet.


Grafiku 20: Rregullat për pjesëmarrjen e femrave në administratën publike




Votimi për kandidatet femra

Sa i takon gatishmërinë së njerëzve për të votuar gratë kandidate, shumica e meshkujve (38%) dhe e femrave (34%) lanë të kuptosh se gjinia e kandidatit nuk përbënte as pengesë e as shtysë për të votuar. Këto shifra nuk ndryshojnë në mënyrë drastike në fshat dhe në qytet. Megjithatë, 55% e femrave në mënyrë të qartë thonë se, po, do ta votonin një grua kandidate, në krahasim me vetëm 37% e meshkujve.

Grafiku 21: Mbështetja e femrave për kandidatet femra



Grafiku 22: Mbështetja e meshkujve për kandidatet femra



Pikërisht për të parë arsyet se përse do të votonin apo nuk do të votonin këta persona për femrat kandidate, kërkohet më shumë studim për të kuptuar motivimin e shoqërisë për përzgjedhjen e kandidatëve. Personat që thanë se do të votonin për kandidatet femra rendisin të mëposhtmet si arsye kryesore: a) i kuptojnë më mirë çështjet shoqërore dhe familjare (që do të thotë se kjo përbën qartë një prioritet për shumë votues); b) perceptohen si më pak të korruptuara; c) nëse është kandidatja më e

mirë për detyrën, do të votonin për të; dhe d) ajo ka më shumë gjasa se do t'i mbajë premtimet.


Këto arsye mbështesin një sërë hipotezash të kahershme në lidhje me rolet gjinore në Shqipëri. Sipas prirejve globale, gratë shqiptare që punojnë në vendimmarrje, në përgjithësi, në poste ku hartohen politikat sociale. Një vërtetim global që ka bërë kohët e fundit Unioni Ndërparlamentar me deputetët ka konstatuar se mbi 90% mendonin se gratë sjellin pikëpamje, perspektiva dhe talente të reja në politikë dhe një përqindje po aq e madhe e meshkujve dhe femrave që morën pjesë në vërtetim besonin se "gratë u japin prioritet atyre çështjeve që mendohet se janë çështje të grave."¹⁶

Sa i takon perceptimit në Shqipëri se gratë politikane janë më pak të korruptuara se politikanët meshkuj (dhe që përgjigjet tregojnë se meshkujt kanë më shumë gjasa ta mendojnë një gjë të tillë) ka një sërë arsyesh të lidhura me këtë. Ajo që ka më shumë të ngjarë, ka një përzierje stereotipash të shoqërisë për gratë: që ato janë më pak agresive, më të përkujdesur, etj., kjo e shoqëruar me faktin se gratë nuk janë angazhuar aktivisht në një sistem të cilin shoqëria në përgjithësi e sheh si të korruptuar. Është interesante të mbështetesh në konstatimet e një analize globale të realizuar nga Banka Botërore në vitin 2001, që ka zbuluar se, edhe pse treguesit tregojnë se në vendet ku ka pasur një rritje të grave në politikë, ka pasur një rritje në korrupsion, një analizë më e thellë i tregon arsyet. "Rritja e numrit të grave në politikë nuk është arsyeja e një korrupsioni të ulët, por e një politike më demokratike dhe transparente, çka lidhet me korrupsion të ulët, dhe këto të dyja krijojnë një mjedis të favorshëm për pjesëmarrjen e më shumë grave në politikë. Në një shoqëri të karakterizuar nga zgjedhje të lira, shtet ligjor dhe ndarje të pushteteve, mbrojtja e lirive elementare e lehtëson hyrjen e grave në pushtet. Në të njëjtën kohë, një politikë më konkurruese dhe transparente i minimizon mundësitë për korrupsion."¹⁷


¹⁶ UNIFEM, "Përparimi i grave në botë, 2008/2009: Kush u jep llogari grave? Gjinia dhe llogaridhënia", faqe 26, www.unifem.org/progress/2008 (për raportin e plotë)

¹⁷ UNIFEM, "Përparimi i grave në botë, 2008/2009", faqe 27.


Grafiku 23: Arsyet kryesore në mbështetje të votimit për kandidatet femra



Grafiku 24: Arsyet e grave në mbështetje të kandidateve femra




Grafiku 25: Arsyet e burrave në mbështetje të kandidateve femra



Po këto stereotipa për femrat shqiptare janë faktorët që pengojnë disa prej pjesëmarrësve në vrojtim për të mos votuar për kandidatet femra. Dhe, në ngjashmëri me ata që mbështesin kandidatet femra, si femrat ashtu edhe meshkujt pjesëmarrës në vrojtim kanë përgjigje shumë të ngjashme kur japin arsyet për të mos i mbështetur ato. Këto arsye e kthejnë lexuesin te 4 C-të e përmendura në "Hyrje", që i pengojnë gratë, globalisht, të mos kenë mundësi futjeje në poste udhëheqjeje, që janë kultura, kujdesi për fëmijët (domethënë, përgjegjësitë tradicionale të grave në shtëpi) dhe mjetet monetare (domethënë, investimi relativisht i pakët nga partitë politike për fushatat e grave.).¹⁸


Kështu, për meshkujt, arsyet kryesore për të mos votuar për kandidatet femra do të ishin: a) arena politike është tepër agresive për një grua; një grua nuk do të kishte kohë të mjaftueshme për t'u marrë me çështjet e qeverisë, po të kemi parasysh përgjegjësitë që ka në shtëpi; c) dhe gratë nuk kanë përvojën apo lidhjet politike të mjaftueshme për të pasur mundësi të realizojnë detyrat. Për femrat që u përgjigjën në vrojtim, arsyet ishin se: a) për shkak të detyrave në familje, një grua nuk do të kishte kohë; b) ajo nuk ka lidhje të mira politike, dhe nuk mund t'i detyrojë vendimmarrësit ta mbajnë vesh, duke qenë se nuk do të ishte agresive sa duhet.

Grafiku 26: Arsyet kryesore për të mos i mbështetur kandidatet femra




¹⁸ UNIFEM, "Përparimi i grave në botë, 2008/2009", faqe 23, www.unifem.org/progress/2008

Grafiku 27: Arsyet e grave për të mos i mbështetur kandidatet femra




Grafiku 28: Arsyet e burrave për të mos i mbështetur kandidatet femra



A janë gratë aktive në bashkësinë tuaj

Kishte një mungesë qartësie kur pjesëmarrësit në vërtetim u pyetën nëse gratë në bashkësinë e tyre luanin apo jo një rol aktiv në jetën publike, ku 41,4% u përgjigjën "po", ndërsa 41.% u përgjigjën "jo". Ka shumë të ngjarë që kjo të lidhet me një paqartësi se çfarë kuptohet me "aktive në bashkësi".


Grafiku 29: Pjesëmarrja e gruas në politikë




Ka shumë të ngjarë që shumë persona, në varësi të moshës dhe arsimit të tyre, ta barazojnë jetën në bashkësi me "jetën publike", si një relikte e perceptimeve të vjetra në lidhje me jetën në bashkësi dhe shtetin. Në shekullin XXI, koncepti i "jetës në bashkësi" është shumë më i gjerë dhe përfshin një pamje më të gjerë të mjeteve të pjesëmarrjes dhe të përkufizimeve të "bashkësisë". Kështu, ky koncept, tashmë, shkon përtej përfaqësimit politik apo anëtarësimit në një parti politike. Për pasojë, këto përgjigje duhet të merren me njëfarë rezerve.

Për ata që thanë se gratë ishin aktive në bashkësi, shumica i perceptonin gratë si të angazhuara në institucionet publike/private përmes punësimit; në marrëdhënie pune me shtetin në sektorin e shërbimeve sociale; dhe anëtare të organeve drejtuese. Për shumë syresh, angazhimi në partitë politike nuk ishte arena ku gratë perceptoheshin si aktive në bashkësi. Është po kështu interesante të vëresh se për thuajse një të dytën e personave pjesëmarrës në vrojtim, gratë perceptoheshin si aktive publikisht. Duket se ka një rritje të ndërgjegjësimit për drejtpeshimin gjinor në jetën publike, ndërkohë që mbeten ende të forta stereotipat në lidhje me rolin e meshkujve në arenën politike.

Grafiku 30: Mënyrat me të cilat mund të jenë aktive në politikë femrat



Grafiku 31: Ndikimi i disa faktorëve në jetën në bashkësi



Subjektet	1=shumë i vogël, 2=i vogël, 3=mesatar, 4=i madh, 5=shumë i madh	
Partitë politike	(1) (2) (3) (4) (5)	(123)
Shoqatat joqeveritare që veprojnë në komunitet	(1) (2) (3) (4) (5)	(124)
Biznesi privat	(1) (2) (3) (4) (5)	(125)
Sektori publik (shkolla, spitali, kopshti i fëmijëve, etj)	(1) (2) (3) (4) (5)	(126)
Pjesëmarrja e gruas në jetën publike	(1) (2) (3) (4) (5)	(127)
Arsye tjetër, (ju lutem specifikoni)	(1) (2) (3) (4) (5)	(128)


Subjektet	shumë i vogël	i vogël	mesatar	i madh	shumë i madh	Gjithsej
Partitë politike	191	242	321	212	202	1.168
Shoqatat joqeveritare që veprojnë në komunitet	180	190	307	291	200	1.168
Biznesi privat	121	228	402	256	161	1.168
Sektori publik (shkolla, spitali, kopshti i fëmijëve, etj)	18	64	272	421	393	1.168
Pjesëmarrja e gruas në jetën publike	47	166	328	313	314	1.168
Arsye tjetër, (ju lutem specifikoni)	1	2	3	9	12	27
Gjithsej	558	892	1.633	1.502	1.282	

Është interesante të theksohet fakti se, sipas perceptimit të personave pjesëmarrës në vrojtim, partitë politike ndodhen në vend të fundit. Ky fakt tregon se rolet e partisë politike mbeten të përcaktuar në aspektin politik në nivel qendror dhe jo në nivel të jetës në bashkësi. Kjo mund të konsiderohet si një zhvillim pozitiv i vlerave të bashkësisë të cilat shihen se mbështeten te pjesëmarrja dhe kontributi i anëtarëve të vet.


Çfarë i pengon gratë për të konkuruar si kandidate

Pyetjes në ka pengesa të perceptuara ndaj mundësisë që kanë gratë për të dalë si kandidate, shumica e grave (47%) u përgjigjën "po", ndërsa përgjigja e meshkujve, nga të cilët 43,30% u përgjigjën "po" dhe 42,80% u përgjigjën "jo", tregon një ndarje më të madhe mes meshkujve në lidhje me këtë çështje. Shumë persona meshkuj që iu përgjigjën pyetjeve dukeshin se ishin të predispozuar të besonin se nëse një femër vendos të paraqitet si kandidate, atëherë nuk ka asgjë në sistem apo në shoqëri që do ta ndalonte. Megjithatë, po të shikosh përgjigjen për këtë pyetje, sipas gjinive, mund të vëresh se për femrat "Tjetër" renditet si përgjigja kryesore, dhe për këtë kërkohet më shumë studim për të përcaktuar se çfarë idesh gjenden pas kësaj përgjigjeje. Arsyeja e dytë kryesore do të ishte qëndrimi patriarkal i bashkëshortit, i cili vazhdon të mos e lejojë gruan të paraqitet si kandidate, si edhe, mbase, mungesa e interesit nga ana e grave për të marrë pjesë në politikë. Sipas meshkujve, pengesa kryesore për gratë që të jenë kandidate në zgjedhje është mungesa e interesit nga ana e grave. Edhe këtu, për të dyja gjinitë, përgjigje "Tjetër" është në përqindje shumë të lartë dhe tregon se mund të ketë pengesa pak të kuptuara apo pak të qarta të cilat i kufizojnë gratë që të marrin pjesë si kandidate në zgjedhje.


Grafiku 32: Çfarë e pengon zgjedhjen e kandidateve femra




Grafiku 33: Pengesat kryesore:



Grafiku 34: Çfarë i pengon femrat të jenë kandidatë në zgjedhje, sipas perceptimit të femrave




Grafiku 35: Çfarë i pengon femrat të jenë candidate në zgjedhje, sipas perceptimit të meshkujve




Përsa u takon pengesave në të cilat hasin gratë kur vjen puna për t'u zgjedhur pasi kanë vendosur të jenë candidate, shumica e personave që iu përgjigjën pyetjeve (45,6%) thanë se perceptojnë se ka një sërë gjërash që e pengojnë zgjedhjen e saj në detyrë. Vihet re sidomos se pengesa kryesore e renditur ishte mungesa e mbështetjes nga politikanët meshkuj (38,6%) dhe mungesa e mbështetjes nga partitë politike (21,6%). Ky konstatim bashkëlidhet me shumë studime globale mbi femrat dhe politikën, sipas të cilëve **partitë përbëjnë mekanizmin kryesor që mund të mbështesë apo të pengojë rritjen e angazhimit të grave në jetën politike dhe publike.**


Grafiku 36: Ekzistenca e pengesave për zgjedhjen e grave



Grafiku 37: Pengesat për pjesëmarrjen e grave në zgjedhje




Grafiku 38: Pengesat



Roli i mjeteve të komunikimit në dhënien formë të opinioneve në zgjedhje është shumë i madh. Femrat candidate dhe politikane kanë përmendur në shumë intervista se mbulimi i grave candidate në mjetet e komunikimit është i dobët në krahasim me kandidatët meshkuj. Duke qenë se mjetet e komunikimit luajnë një rol kyç në krijimin e një mjedisi të favorshëm që kandidatet femra të pranohen nga shoqëria dhe, më tej, duke qenë se mjetet e komunikimit luajnë një rol kyç, shpesh, në përforcimin e

stereotipave, është thelbësore që mbrojtësit e barazisë gjinore të kenë një pamje të qartë të ndikimit që ka media në gratë në zgjedhje. Sipas atyre që iu përgjigjen pyetjeve, televizioni dhe radio ka bërë mbulimin më të madh të kandidatëve femra në zgjedhjet e shkuara, por mbulimi, sipas tyre, mbetet ende i pamjaftueshëm.


Grafiku 39: Shkalla në të cilën mjetet masive të komunikimit mbulojnë pjesëmarrjen e grave në zgjedhje



Vlerësimi këtu bëhet sipas shkallës, 1-shumë pak hapësirë, deri në 5-shumë mbulim.

Siç duket edhe në grafikun 39, duke krahasuar shkallën e mbulimit në mjetet e komunikimit, është e qartë se radiotelevizioni kombëtar bën një mbulim të plotë të pjesëmarrjes së grave në zgjedhje, e ndjekur nga radiotelevizioni vendor dhe, në vend të tretë, ndodhet shtypi (gazetat dhe revistat). Ky klasifikim shpreh, nga njëra anë, kapacitetin teknik dhe nivelin profesional të mjeteve të komunikimit dhe, nga ana tjetër, vëzhgimin e tyre nga institucionet përkatëse përfshirë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Këshillin Kombëtar të Radiotelevizionit, etj. Ndërkohë, shtypi (gazetat dhe revistat) ndodhet në vendin e tretë sepse është më shumë i interesuar të shitet dhe një pjesë e madhe e tyre kanë një auditor vërtet të kufizuar.

Grafiku 40: Vlerësimi i mundësisë për të përdorur mediat, për kandidatët meshkuj dhe femra




Siç duket edhe nga grafiku 40, vetëm një përqindje e vogël e pjesëmarrësve në anketë dhanë një "Po" të pastër për pyetjen në lidhje me mundësinë e barabartë për të përdorur mjetet masive të komunikimit, si për kandidatët meshkuj ashtu edhe për ato femra, por këtu numri i përgjigjeve negative (30,4%) është thajse dy herë më i lartë se përgjigjet hezituese "Mbase jo" (16,6%). Ky informacion tregon diskriminimin e kandidateve femra nga mjetet e komunikimit, edhe pse një pjesë e kësaj do të ishte për shkak të numrit të ulët të kandidateve femra në krahasim me ata meshkuj. Mirëpo, mungesa e mbulimit në mjetet e komunikimit tregon edhe mungesën e mundshme të mbështetjes për kandidimin e femrës brendapërbrenda partisë politike, e cila shpesh negocion dhe paguan për mbulimin në mjetet e komunikimit. Në përgjithësi, mjetet shqiptare të komunikimit në masë, sidomos ajo audiovizive, janë të motivuara nga pengesat joformale të kandidateve dhe/ose grupeve të biznesit që qëndrojnë pas tyre dhe nga ndikimi politik i Qeverisë.

Pyetjet kyçe:


Pyetje: "Sikur kësaj të diele të mbahen zgjedhjet vendore dhe në zgjedhje të kishte dy kandidatë, një mashkull dhe një femër, a do të kishte më shumë mundësi të votonit për kandidatet femër?"

Grafiku 41: Parapëlqimi për kandidatët femra dhe meshkuj



Ajo që del qartë nga përgjigja më lart, si edhe nga pyetjet e tjera të lidhura me të, që janë paraqitur në rubrikat më lart të këtij vrojtimi, në përgjithësi votuesit jo medoemos e perceptojnë veten se kanë ndonjë parapëlqim për kandidatët meshkuj apo femra.

Grafiku 42: Parapëlqimi i votuesve për kandidatët, sipas gjinive




	Femra	Meshkuj	Gjithsej
kandidaten femër të partisë që pëlqeni	213	129	342
Vetëm kandidatin mashkull	13	50	63
mbase, për kandidaten femër	123	75	198
mbase, për kandidatin mashkull	21	68	89
Nuk e di	205	217	422
Nuk pranojnë të përgjigjen	25	29	54
Gjithsej	600	568	1.168


Nga sa më sipër, duhet të vëmë re se ka një numër të konsiderueshëm personash që u janë përgjigjur pyetjeve (më shumë se një e treta) të cilët janë të pavendosur në lidhje me faktin se si do të ndikonte gjinia e kandidatit në përzgjedhjen e tyre. Kështu, përgjigja e përgjithshme për këtë pyetje duket se është "i pavendosur".

Nga përgjigjet për pyetjen se si i përzgjedhin njerëzit kandidatët për të cilët votojnë dhe se cilët faktorë ndikojnë hedhjen e votës së tyre, del qartë se gratë dhe burrat kërkojnë, në fund të fundit, kandidatin i cili është më i besuari, si dhe shohin edhe mandatin e partisë që përfaqëson kandidati. Mund të vihet re se në këtë pyetje të veçantë, ndikimi i familjes në votën e gruas është më pak i dukshëm, por, megjithatë, është më shumë i dukshëm se në përgjigjet e meshkujve.

Grafiku 43: Parapëlqimi i votueseve femra



Grafiku 44: Parapëlqimi i votuesve meshkuj



- Unë diskutova me shokë dhe miq dhe ndoqa këshillat e tyre se për kë të votoja
- Diskutova me pjesëtarë të familjes dhe ndoqa këshillat e tyre se për kë të votoja
- U përpoqa të dija nëse kandidati ishte ose jo i korruptuar
- Unë u takova me kandidatin dhe besova në platformën dhe premtimet e tij
- Mendova nëse unë ose familja ime do të kishim mundësi të qanim hallet me kandidatin
- Tjetër
- Familja ime tradicionalisht ka votuar për këtë parti që unë votova
- Kandidati ka qenë një drejtues (udhëheqës) me ndikim pozitiv dhe i njohur për zonën tonë
- Unë votova për partinë të cilën përfaqësonte kandidati
- Vlerësova nëse kandidati ka plotësuar ose jo premtimet ose nëse ai/ajo do të jetë i aftë të mbajë premtimet e veta

Pyetje: *Sipas mendimit tuaj, do të ishin dakord që një femër të mund të zgjidhet/emërohet në postin e mëposhtëm?*

Grafiku 45: Parapëlqimet për postet ku mund të zgjidhen/emërohen femrat






Tabela më lart dhe grafikët më poshtë tregojnë se ka një hapje të përgjithshme në drejtim të grave në disa poste të caktuara, siç janë ato në kujdesin social, shëndetësinë dhe drejtësi. Megjithatë, kur bëhet parashikimi për gratë në postet më të larta (kryetar komune, kryeministër dhe president) në përgjigjet e tyre pjesëmarrësit ndihen më pak mirë me gratë në këto poste drejtuese. Është sidomos interesante të vëresh se si pjesëmarrësit meshkuj edhe ato femra dhanë përgjigje shumë të ngjashme për këtë pyetje.

Grafiku 46: Parapëlqimet e votueseve femra për postet ku mund të zgjidhen/emërohen femrat




Grafiku 47: Sipas mendimit tuaj, do të ishin dakord që një femër të mund të zgjidhet/emërohet në postin e mëposhtëm? (Meshkujt)



Vlerësimi për kandidatet femra:

Nga grafiku 47, mund të arrihet në përfundimin se shumica e pjesëmarrësve në vrojtim mendojnë se caktimi i kandidateve femra në poste publike do të çojë në përmirësim të situatës për të drejtat e njeriut dhe, ajo që është interesante, do të rriste mundësinë e Shqipërisë për të marrë mbështetje ndërkombëtare, përfshirë këtu edhe integrimin në Bashkimin Evropian. Këto dy arsye të fundit mund të lidhen me idenë se gratë si udhëheqëse do të perceptoheshin si më pak të korruptuara dhe mund të sjellin sisteme më të hapura dhe transparente të qeverisjes, çka janë edhe prioritete të partnerëve ndërkombëtarë të Shqipërisë. Nga ana tjetër, kandidatët meshkuj perceptohen si më të shkathët me shtetin ligjor dhe garantimin e sigurisë së vendit, përfshirë këtu edhe luftën kundër krimit të organizuar.


Grafiku 48: Vlerësimi për kandidatët meshkuj (1 – tërësisht kundër; 5 – tërësisht pro)



ANEKSI I: PROFILI I PJESËMARRËSVE NË VROJTIM

P.33: A punoni?


Grafiku i P.33: Informacion mbi statusin e punesimit te respondenteve



Informacioni në grafikun e pyetjes nr. 33 përfshin një shkallë të lartë subjektivizmi, kështu që duhet marrë me rezerva sa i takon shkallës së papunësisë, që raportohet në një nivel 2 herë më të lartë se të dhënat zyrtare të papunësisë në vend. Vlen të theksohet se për shumicën e personave pjesëmarrës në vrojtim "të zënë me punë" konsiderohet ata persona që punojnë ligjërisht (me kontratë) për një periudhë të caktuar kohore dhe, sidomos, për një periudhë të gjatë, përgjithësisht, në sektorin publik. Punësimi në sektorin privat, punësimi me kohë të pjeshme dhe, sidomos, vetëpunësimi në bizneset e vogla, në shumë raste, nuk raportohen, prandaj edhe nuk deklarohen.

P.34: A i përkisni një besimi të caktuar fetar?


Grafiku i P.34: Besimi Fetar



Nga informacioni i grafikut të pyetjes nr. 34 duket fakti se në Shqipëri, një pjesë jo e vogël (9%) e personave deklarojnë se nuk i përkasin asnjë besimi fetar. Megjithatë, edhe ajo pjesë e personave që mendojnë se i përkasin një besimi fetar qëndron në të njëjtën shkallë.


P.35: Nëse Po, cilit besim i përkisni?

Grafiku i P.35 Besimi Fetar



P.36: Mesatarisht, sa janë të ardhurat mujore të familjes suaj?


Grafiku i P.36
Te Ardhurat Mujore



Sipas informacionit të grafikut të pyetjes nr. 36, shumica e familjeve shqiptare të marra në intervistë (47,3%) kanë të ardhura mujore mesatare midis 20.000 (njëzetmijë) lekë dhe 50.000 (pesëdhjetëmijë) lekë. Sipas deklarimeve të pjesëmarrësve në vrojtim, segmenti i popullsisë i cili ndodhet nën këtë nivel dhe mbi këtë nivel është thuhetse i barabartë (23,04% dhe 22,95%). Megjithatë, ky nivel të ardhurash tregon ekzistencën e varfërisë në familjet shqiptare, si edhe polarizimin e dukshëm social në Shqipëri.

P37: Si do t'i vlerësonit të ardhurat e familjes suaj gjatë këtij viti, në krahasim me vitin 2006?

Grafiku i P.37: Krahasimi i të Ardhurave Familjare 2007/2006



Siç duket edhe në grafikun e pyetjes nr. 37, kjo pyetje ka për synim të shikojë perceptimin në lidhje me përparimin që ka pasur ulja e varfërisë, sipas këndvështrimit të të ardhurave familjare. Me gjithë ndryshueshmërinë në përgjigje, duket se për shumicën e pjesëmarrësve në vrojtim (39,4%) niveli i të ardhurave nuk ka ndryshuar. Nëse marrim në konsideratë edhe atë pjesë të pjesëmarrësve në vrojtim të cilët janë përgjigjur se të ardhurat e tyre kanë rënë (32,3%), mund të arrihet në përfundimin se gjatë vitit 2007, në krahasim me një vit më parë, edhe pse ka pasur një rritje në të ardhurat nominale të familjeve shqiptare, niveli i tyre dhe cilësia e jetës ka rënë.

ANEKSI II – PYETËSOR TIP

ID e Intervistës:

Nr. i Bashkësisë

Nr. i të Intervistuarit në
Bashkësi

PYETËSOR Nr. _____

PREZANTIMI: Mirëdita, më quajnë _____ dhe punoj për ACER dhe ASET. Ne bëjmë vrojtime mbi tema të ndryshme dhe ky i sotmi fokusohet mbi në pjesëmarrjen e grave në votime. Ju jeni përzgjedhur rastësisht për të qenë një nga njëmijë personat e intervistuar mbi këtë temë në të gjithë Shqipërinë. Ne ruajmë anonimat e përgjigjeve në këtë vrotim dhe informacioni është konfidencial. Nuk jeni i/e detyruar të merrni pjesë, nëse nuk dëshironi.

Data e intervistës _____ /11 / 2007

Ora e fillimit të intervistës _____

Ora e mbarimit të intervistës _____

A. TË DHËNA DEMOGRAFIKE DHE EKONOMIKE

Gjinia e personit të intervistuar? 1=Femër 2=Mashkull

(1) (2) (1)

Mosha e personit të intervistuar?

1=18-24 vjeç, 2=25-34 vjeç, 3=35-44 vjeç, 4=45-54 vjeç, 5= mbi 54 vjeç

(1) (2) (3) (4) (5) (2)

Gjendja civile e personit të intervistuar?

1=Beqar/e, 2=I/E martuar, 3=I/E ndarë, 4=I/E divorcur, 5=I/E ve

(1) (2) (3) (4) (5) (3)

Numri i fëmijëve të personit të intervistuar?

1= Nuk ka, 2= 1 deri në 2, 3= 3 deri në 4, 4= Më shumë se katër

(1) (2) (3) (4) (4)

5- Niveli arsimor më i lartë që ka kryer i intervistuari? 1=pa asnjë klasë shkolle, 2=fillor, 3=tetëvjeçar, 4=2 vjeçare teknike, 5=e mesme teknike,

6=e mesme e përgjithëshme, 7=universitar, 8=pasuniversitar

(1) (2) (3) (4) (5) (6) (7) (8) (5)

Profesioni i personit të intervistuar?

_____ (6)

Nga sa persona (përfshirë dhe ju) përbëhet familja juaj? _____
persona (7)

A punoni? 1=Jo, 2=Po, 99=Refuzoj të përgjigjem
(1) (2) (99) (8)

A i përkisni një besimi? 1=Jo, 2=Po, 99=Refuzoj të përgjigjem
(1) (2) (99) (9)

Nëse PO, cilit besim? 1=Hebre, 2=Protestant, 3=Mysliman, 4=Katolik,
5=Ortodoks, 6=Bektashi, 7=Bahai, 8=Tjetër, specifiko_____,
99=Refuzoj të përgjigjem (1) (2) (3) (4) (5) (6) (7) (8) (99)
(10) (10a)

Mesatarisht, sa janë të ardhurat mujore të familjes suaj? 1=Deri në
5 mijë lekë të reja, 2=5 deri në 10 mijë lekë të reja, 3=10 deri në 20
mijë lekë të reja, 4=20 deri në 50 mijë lekë të reja, 5=Mbi 50 mijë
lekë të reja
(1) (2) (3) (4) (5) (11)

**Si do t'i vlerësonit të ardhurat e familjes suaj gjatë këtij viti, në
krahësim me vitin 2006?**

1= Janë rritur shumë, 2=Janë rritur, 3=Nuk kanë ndryshuar, 4=Janë
pakësuar, 5=Janë pakësuar shumë, 99=Refuzoj të përgjigjem
(1) (2) (3) (4) (5) (99) (12)

B. PSE DHE SI VOTOJNË NJERËZIT

**13- A keni qenë ndonjëherë ju, kandidat(e) për t'u zgjedhur në
një proces zgjedhor? (p.sh. zgjedhje parlamentare, lokale, në
këshillat e shkollave, etj.)** 1=Jo, 2=Po, 99=Refuzoj të përgjigjem
(1) (2) (99) (13)

A votuat në zgjedhjet vendore të datës 18 shkurt 2007?

1=Jo, 2=Po, 99=Refuzoj të përgjigjem
(1) (2) (99) (14)

A votuat në zgjedhjet parlamentare të datës 3 korrik 2005?

1=Jo, 2=Po, 99=Refuzoj të përgjigjem
(1) (2) (99) (15)

Nëse përgjigjet e pyetjeve 14 dhe 15 janë të dyja JO, atëherë kalo te
pyetja 19

A ju ka ndihmuar njeri në procesin e votimit?

1=Jo, 2=Po, 99=Refuzoj të përgjigjem
(1) (2) (99) (16)

Intervistuesi: Nëse përgjigja e kësaj pyetjeje nuk është PO atëhere kaloni
te pyetja 20

Nëse PO, kush ju ka ndihmuar? 1=familjar, 2=anëtar i KQV-së, ose
vëzhgues, 3=një person i panjohur, 99=refuzoj të përgjigjem
(1) (2) (3) (99) (17)

Nëse PO, shpjegoni se në ç'mënyrë? 1=Duke më treguar si votohet,
2=Duke më shoqëruar te dhoma e fshehtë dhe sugjeruar si të votoj,
3=Duke më treguar se për kë të votoj, 99=Refuzoj të përgjigjem
(1) (2) (3) (99) (18)

Nëse nuk keni votuar, kjo për arsye se: 1=Nuk kisha emrin në listën e zgjedhësve, 2=Nuk kisha dokument identiteti, 3=Nuk votoi asnjë nga familja ime, 4=Nuk më pëlqyen kandidatët, 5=Kandidatja e partisë që pëlqej ishte femër, 6=Nuk kisha mbushur moshën 18 vjeç, 99=Refuzoj të përgjigjem

(1) (2) (3) (4) (5) (6) (99) (19)

Pyetje vetëm për personat e martuar: A ka votuar gruaja/burri juaj në zgjedhjet e fundit lokale? 1=Jo, 2=Po, 9=Nuk e di, 99=Refuzoj të përgjigjem

(1) (2) (9) (99) (20)

Në zgjedhjet e fundit lokale, dhe/ose parlamentare, a keni parë raste kur votues të tjerë të votojnë së bashku në grup, apo familjarisht? 1=Jo, 2=Po, 9=Nuk e di, 99=Refuzoj të përgjigjem

(1) (2) (9) (99) (21)

22- Nëse do t'jua kërkonin njerëzit e familjes suaj, a do ishte më mirë që një pjesëtar i familjes të votonte për gjithë familjen? 1=Jo, 2=Mbase Jo, 3=Mbase Po, 4=Po, 9=Nuk e di, 99=Refuzoj të përgjigjem

(1) (2) (3) (4) (9) (99) (22)

23- Sa të ngjarë ka që ju të votoni në zgjedhjet e ardhshme parlamentare? 1=Nuk do të votoj, 2=Mbase nuk do të votoj, 3=Mbase do të votoj, 4=Do të votoj, 9=Nuk e di nëse do të votoj ose jo, 99=Refuzoj të përgjigjem

(1) (2) (3) (4) (9) (99) (23)

Në zgjedhjet e fundit lokale, si vendosët për votën tuaj?

Arsyeja	1=Jo, 2=Mbase jo, 3=Mbase po, 4=Po	
Vlerësova nëse kandidati ka plotësuar ose jo premtimet ose nëse ai/ajo do të jetë i aftë të mbajë premtimet e veta.	(1) (2) (3) (4)	(24)
Mendova nëse unë ose familja ime do të kishim mundësi të qanim hallet me kandidatin	(1) (2) (3) (4)	(25)
Kandidati ka qenë një drejtues (udhëheqës) me ndikim pozitiv dhe i njohur për zonën tonë	(1) (2) (3) (4)	(26)
U përpoqa të vlerësoj nëse kandidati ishte ose jo i korruptuar	(1) (2) (3) (4)	(27)
Unë votova për partinë të cilën përfaqësonte kandidati	(1) (2) (3) (4)	(28)
Diskutova me pjesëtarë të familjes dhe ndoqa këshillat e tyre se për kë të votoja	(1) (2) (3) (4)	(29)
Unë u takova me kandidatin dhe isha dakord me platformën dhe angazhimet që më premtoi	(1) (2) (3) (4)	(30)
Unë diskutova me shokë dhe miq dhe ndoqa këshillat e tyre se cilën parti/cilin kandidat të mbështesja	(1) (2) (3) (4)	(31)
Familja ime tradicionalisht ka votuar për këtë parti	(1) (2) (3) (4)	(32)
Arsye tjetër, (ju lutem specifikoni)	(1) (2) (3) (4)	(33) (33a)

Vlerësoni në shkallë nga 1 në 5 se sa të rëndësishme janë problemet që ju dëshironi që një person i zgjedhur të trajtojë dhe të zgjidhë gjatë mandatit të tij?

Arsyeja	1=shumë pak e rëndësishme, 2=pak e rëndësishme, 3= mesatarisht e rëndësishme, 4=e rëndësishme, 5=shumë e rëndësishme	
Rritja e mundësive për punësim	(1) (2) (3) (4) (5)	(34)
Sigurimi i furnizimit me energji elektrike dhe ujë	(1) (2) (3) (4) (5)	(35)
Përmirësimi i sistemit shëndetësor	(1) (2) (3) (4) (5)	(36)
Përmirësimi i sistemit të kujdesit ndaj fëmijëve	(1) (2) (3) (4) (5)	(37)
Përmirësimi i sistemit arsimor	(1) (2) (3) (4) (5)	(38)
Rritja e mbështetjes për të drejtat e njeriut të grave	(1) (2) (3) (4) (5)	(39)
Rritja e pagave dhe e pagesave nga mbrojtja sociale	(1) (2) (3) (4) (5)	(40)
Përmirësimi i rrugëve	(1) (2) (3) (4) (5)	(41)
Përmirësimi i transportit publik	(1) (2) (3) (4) (5)	(42)
Nxjtja e një mjedisi më të mirë për biznesin	(1) (2) (3) (4) (5)	(43)
Ulja e tatimeve	(1) (2) (3) (4) (5)	(44)
Sigurimi i një administrate publike më mikpritëse dhe efikase	(1) (2) (3) (4) (5)	(45)
Ulja e korrupsionit të zyrtarëve publikë dhe administratës publike	(1) (2) (3) (4) (5)	(46)
Sigurimi i një sistemi gjyqësor të drejtë dhe të efektshëm	(1) (2) (3) (4) (5)	(47)
Përmirësimi i efektivitetit të forcave të policisë	(1) (2) (3) (4) (5)	(48)
Rritja e barazisë gjinore në vend/komunitet	(1) (2) (3) (4) (5)	(49)
Sigurimi i një mjedisi të sigurt në komunitet	(1) (2) (3) (4) (5)	(50)
Dhënia e më shumë mundësive për të rinjtë	(1) (2) (3) (4) (5)	(51)
Sigurimi i një mjedisi më të pastër	(1) (2) (3) (4) (5)	(52)
Mbështetja për të udhëtuar dhe migruar jashtë vendit	(1) (2) (3) (4) (5)	(53)
Arsye tjetër, (ju lutem specifikoni)	(1) (2) (3) (4) (5)	(54) (54a)

C. PJESËMARRJA E GRAVE NË ZGJEDHJE DHE NË POLITIKË

A mendoni se duhet të kemi më shumë gra në poste të zgjedhura dhe të emëruara?

1=Jo, 2=Po, 9=Nuk e di, 99=Refuzoj të përgjigjem
(1) (2) (9) (99) (55)

A mendoni se duhet të ketë rregulla ligjore që të përcaktojnë përqindjen minimale të grave që duhet të zgjidhen? 1=Jo, 2=Po,

9=Nuk e di, 99=Refuzoj të përgjigjem
(1) (2) (9) (99) (56)

A mendoni se duhet të ketë rregulla ligjore që të përcaktojnë përqindjen minimale të grave në poste të emëruara?

1=Jo, 2=Po, 9=Nuk e di, 99=Refuzoj të përgjigjem
(1) (2) (9) (99) (57)

A do të votonit për një kandidatë femër?

1=Jo, 2=Po, 3=Gjinia e kandidatit nuk ka asnjë rëndësi 9=Nuk e di, 99=Refuzoj të përgjigjem (1) (2) (3) (9)(99) (58)

Nëse përgjigja për pyetjen 29 është PO: A mund të shpjegoni se përse do të votonit për një kandidatë femër?

Arsyeja	1=Jo, 2=Po	
Ajo ishte/është kandidatja më e mirë	(1) (2)	(59)
Ajo mund të kuptojë më mirë problemet sociale dhe të familjes	(1) (2)	(60)
Ajo mund të punojë më shumë se sa një kandidat mashkull	(1) (2)	(61)
Ajo mund të jetë më e aftë për t'i përmbushur përgjegjësitë e saj se sa një kandidat mashkull	(1) (2)	(62)
Ajo mund të sigurojë përmirësimin e administrimit të burimeve të qeverisë	(1) (2)	(63)
Ajo mund të mbajë premtimet e dhëna	(1) (2)	(64)
Ajo mund të takohet më me lehtësi se sa një kandidat/politikan mashkull	(1) (2)	(65)
Ajo mund të jetë më pak e korruptueshme se sa një kandidat mashkull	(1) (2)	(66)
Arsye tjetër, (ju lutem specifikoni)	(1) (2)	(67) (67a)

Nëse përgjigja për pyetjen 30 është JO: A mund të shpjegoni se cilat nga arsyet e mëposhtme do t'ju bënin ju të mos votonit për një kandidatë femër:

Arsyeja	1=Jo, 2=Po	
Gratë nuk sjellin asgjë të re në jetën politike dhe atë të vendimmarrjes	(1) (2)	(68)
Gratë nuk e kanë kohën e mjaftueshme për t'u marrë me problemet e qeverisjes sepse kanë preokupime familjare	(1) (2)	(69)
Gratë nuk mund t'i kuptojnë mirë probleme të tilla si reforma ekonomike, integrimi në BE, lufta ndaj korrupsionit, reforma juridike, etj.	(1) (2)	(70)
Gratë nuk kanë lidhje të forta politike, kështu që do të kenë vështirësi për të zbatuar detyrat që u ngarkohen nga posti që do të kenë	(1) (2)	(71)
Vendimmarrësit nuk do të dëgjonin me kujdes një grua	(1) (2)	(72)
Bota e politikanëve është shumë agresive dhe gratë do të kishin frikë të merrnin vendime të drejta	(1) (2)	(73)

Gratë nuk kanë eksperiencën e mjaftueshme	(1) (2)	(74)
Gratë nuk janë inteligjente për t'u marrë me punë të tilla	(1) (2)	(75)
Arsye tjetër, (ju lutem specifikoni)	(1) (2)	(76)(76a)

Sipas mendimit tuaj, a janë aktive gratë në jetën publike të komunitetit tuaj?

1=Jo, 2=Po, 9=Nuk e di, 99=Refuzoj të përgjigjem
(1) (2) (9) (99) (77)

Nëse ju përgjigjeni PO: A mund të shpjegoni mënyrën se si ato janë aktive në jetën e komunitetit tuaj?

1=Nëpërmjet pjesëmarrjes në organizatat e partive politike, 2=Nëpërmjet të qenit e zgjedhur në organet drejtuese të pushtetit, 3=Nëpërmjet të qenit e punësuar ose drejtuese në institucionet publike/private, 4=Nëpërmjet punës vullnetare për komunitetin, 5=Nëpërmjet punës vullnetare për besimtarët e fesë, 6=Nëpërmjet të qenit e punësuar ose drejtuese në shërbimet bazë sociale (Mami, infermiere, mësuese, etj), 7=Tjetër, specifikoni _____
(1) (2) (3) (4) (5) (6) (7) (78)(78a)

Nëse ju përgjigjeni JO: Ju lutem, jepni mendimin tuaj se përse gratë nuk janë aktive në jetën e komunitetit tuaj.

(79)

A mendoni se ka pengesa për pjesëmarrjen e grave si votuese gjatë votimeve parlamentare ose vendore?

1=Jo, 2=Po, 9=Nuk e di, 99=Refuzoj të përgjigjem
(1) (2) (9) (99) (80)

Nëse PO, cilat janë pengesat sipas mendimit tuaj?

	1=Jo, 2=mbase jo, 3=mbase po, 4=Po	
Qëndrimi patriarkal i bashkëshortit	(1) (2) (3) (4)	(81)
Mentaliteti patriarkal i familjes, rrethit farefisnor, komunitetit	(1) (2) (3) (4)	(82)
Besimi se burri i saj do të votojë për të	(1) (2) (3) (4)	(83)
Infrastruktura e pazhvilluar fizike (rrugë, shkollë, spital, etj.)	(1) (2) (3) (4)	(84)
Problemet ekonomike të familjes	(1) (2) (3) (4)	(85)
Mungesa e interesit për politikën	(1) (2) (3) (4)	(86)
Arsye tjetër, (ju lutem specifikoni)	(1) (2) (3) (4)	(87) (87a)

A mendoni se ka pengesa për femrat për t'u zgjedhur në zgjedhjet parlamentare ose vendore?

1=Jo, 2=Po, 9=Nuk e di, 99=Refuzoj të përgjigjem (1) (2) (9) (99)
(88)

Nëse PO, cilat janë pengesat sipas mendimit tuaj? 1=Lufta brenda partisë, 2=Frika e grave për t'u marrë me politikë, 3=Mungesa e mbështetjes nga politikanët meshkuj, 4=Mungesa e eksperiencës, 9=Nuk e di, 99=Refuzoj të përgjigjem (1) (2) (3) (4) (9) (99) (89)

Vlerësoni shkallën në të cilën mjetet masive të komunikimit mbulojnë pjesëmarrjen e grave në zgjedhjet vendore.

Mjetet e komunikimit masiv	Për pjesëmarrjen e grave në votime si votuese	Për proporcionin e kandidateve femra për t'u zgjedhur		
	1=shumë i vogël, 2=i vogël, 3=mesatar, 4=i madh, 5=shumë i madh	1=shumë i vogël, 2=i vogël, 3=mesatar, 4=i madh, 5=shumë i madh		
Gazetat dhe revistat	(1) (2) (3) (4) (5)	(1) (2) (3) (4) (5)	(90)	(93)
Radiot dhe televizionet kombëtare	(1) (2) (3) (4) (5)	(1) (2) (3) (4) (5)	(91)	(94)
Radiot dhe televizionet lokale	(1) (2) (3) (4) (5)	(1) (2) (3) (4) (5)	(92)	(95)

A mendoni se kandidatët meshkuj dhe femra kanë mundësi të barabarta për të përdorur mjetet e komunikimit në masë, gjatë fushatave elektorale? 1=Jo, 2=Mbase jo, 3=Mbase po, 4=Po, 9=Nuk e di, 99=Refuzoj të përgjigjem (1) (2) (3) (4) (9) (99) (96)

Sikur kësaj të diele të mbahen zgjedhjet vendore dhe në zgjedhje të kishte dy kandidatë, një mashkull dhe një femër, për cilin ka më shumë gjasa se do të votoni? 1=kandidaten femër të partisë që ju pëlqen, 2=vetëm një kandidat mashkull, 3=mbase për kandidaten femër, 4=mbase për kandidatin mashkull, 9=Nuk e di, 99=Refuzoj të përgjigjem (1) (2) (3) (4) (9) (99) (97)

Sipas mendimit tuaj, a do të ishit dakord që në postet e mëposhtme të votohet/të emërohet një femër? Vlerësoni nga 1 në 5 ku 1=plotësisht kundër dhe 5=plotësisht dakord, 9=nuk e di, 99=refuzoj të përgjigjem

Posti		
Presidenti	(1) (2) (3) (4) (5) (9) (99)	(98)
Kryetari i Kuvendit	(1) (2) (3) (4) (5) (9) (99)	(99)
Kryeministri	(1) (2) (3) (4) (5) (9) (99)	(100)
Ministër	(1) (2) (3) (4) (5) (9) (99)	(101)
Parlamentar	(1) (2) (3) (4) (5) (9) (99)	(102)
Kryetar bashkie	(1) (2) (3) (4) (5) (9) (99)	(103)

Kryetar komune	(1) (2) (3) (4) (5) (9) (99)	(104)
Këshilltar	(1) (2) (3) (4) (5) (9) (99)	(105)
Kryetar i Këshillit të Rrethit	(1) (2) (3) (4) (5) (9) (99)	(106)
Gjyqtar	(1) (2) (3) (4) (5) (9) (99)	(107)
Drejtor shkolle, drejtor spitali	(1) (2) (3) (4) (5) (9) (99)	(108)

Duke pasur parasysh një kandidate femër dhe një kandidat mashkull, a mund të shprehni mendimet tuaja nëse jeni: 1=plotësisht jo dakord, 2=disi jo dakord, 3=neutral, 4=disi dakord, 5=plotësisht dakord, 9=nuk e di, 99=refuzoj të përgjigjem ndaj karakteristikave në vijim:

	Për kandidaten femër	Për kandidatin mashkull		
Mund të përmirësojë situatën ekonomike	(1) (2) (3) (4) (5) (9) (99)	(1) (2) (3) (4) (5) (9) (99)	(109)	(116)
Mund të mbajë qetësinë në vend	(1) (2) (3) (4) (5) (9) (99)	(1) (2) (3) (4) (5) (9) (99)	(110)	(117)
Mund të ulë korrupsionin në qeveri	(1) (2) (3) (4) (5) (9) (99)	(1) (2) (3) (4) (5) (9) (99)	(111)	(118)
Mund të luftojë krimin e organizuar	(1) (2) (3) (4) (5) (9) (99)	(1) (2) (3) (4) (5) (9) (99)	(112)	(119)
Mund të përmirësojë situatën e të drejtave të njeriut në vend	(1) (2) (3) (4) (5) (9) (99)	(1) (2) (3) (4) (5) (9) (99)	(113)	(120)
Mund të marrë ndihma ndërkombëtare për vendin	(1) (2) (3) (4) (5) (9) (99)	(1) (2) (3) (4) (5) (9) (99)	(114)	(121)
Mund të integrojë Shqipërinë në Evropë	(1) (2) (3) (4) (5) (9) (99)	(1) (2) (3) (4) (5) (9) (99)	(115)	(122)

Vlerësoni ndikimin e faktorëve të mëposhtëm në rritjen e rolit drejtues të gruas në jetën e komunitetit?

Subjektet	1=shumë i vogël, 2=i vogël, 3=mesatar, 4=i madh, 5=shumë i madh	
Partitë politike	(1) (2) (3) (4) (5)	(123)
Shoqatat joqeveritare që veprojnë në komunitet	(1) (2) (3) (4) (5)	(124)
Biznesi privat	(1) (2) (3) (4) (5)	(125)
Sektori publik (shkolla, spitali, kopshti i fëmijëve, etj)	(1) (2) (3) (4) (5)	(126)
Pjesëmarrja e gruas në jetën publike	(1) (2) (3) (4) (5)	(127)
Arsye tjetër, (ju lutem specifikoni)	(1) (2) (3) (4) (5)	(128)

FALEMINDERIT!

Shënim i ACER dhe ASET (Intervistues: Kjo pjesë do të plotësohet në zyrën e ACER dhe ASET)

Data e marrjes në dorëzim të pyetësorit të plotësuar

Marrësi në dorëzim

Nënshkrimi i intervistuesit

Shënime shpjeguese rreth procesit të vrojtimit dhe besueshmërisë së të dhënave të deklaruara:
